



SEMA-SOMA* E LIBRIT

NYSRET KRASNIQI

Po nisemi në një aventurë të mendimit?!

Zurkajat e mendimit, siç do të thoshte Anton Pashku ynë, të lidhin dhe të fundosin nëpër thellësi të kohëve pa kohë, të kohëve me dritë dhe pa dritë, në mendimin “e vjetër” dhe “të ri” etj., sepse, thujse empirikisht, është imanencë e trurit “rebel” që të hyjë në lëmshin e këtyre zurkajave, të cilat s’kanë as fill as mbarim.

Me këtë rast, po pretendojmë që gjithçka, pra Botën, ta shohim si një përbërje fenomenologjike të shenjave-librave, por duke i menduar vetëm konceptet që dalin nga to?! Sistemin e shenjave e praktikuan syryrianët, por edhe të tjerët, para dhe pas tyre, mirëpo e ngushtuan tepër fort motivimin.

Motivimi u hetua në Antikë, vazhdoi në forma të ndryshme në Mesjetë e Renesancë, për t’u ridimensionuar më vonë si fenomenologji paralele në filozofi dhe në koncepte të tjera të riciklueshme të dijeve të ndryshme.

/ vijon në faqen 8 /



* Në gjuhën e vjetër greke sema-soma nënkuptonte shenjën dhe varrin, por që natyrshëm motivoheshin duke e nënkuptuar një reflektim kuptimor ndaj një sendi apo fenomeni.

“BIBLIOTEKA” nr.2/2005

Një ngjarje e veçantë për bibliotekarinë në Kosovë, në përgjithësi, dhe për Shoqatën e Bibliotekarëve të Kosovës, në veçanti, është dalja e numrit të dytë (2) të revistës "Biblioteka", revistë e Shoqatës së Bibliotekarëve të Kosovës, e cila po sheh dritën pas 21 vjetësh, prej daljes së numrit të parë (1984).

Si një revistë me përmbledhje punimesh, e ndarë në nëntë (9) kaptina, fillon me editorialin e drejtorit të BKUK-së, dr. Sali Bashota *"Biblioteka - revistë e ideve dhe koncepteve bibliotekare"*, për të vazhduar me punimin e B. Gashit *"Rrjeti bibliotekar në Kosovë"*, në të cilin pasqyrohet në mënyrë kronologjike e kaluara dhe e tashmja e zhvillimit të bibliotekarisë në Kosovë, si dhe sfidat që i presin bibliotekat me rastin e automatizimit - si një proces i patejkalueshëm për të ardhmen. Të drejtat dhe obligimet e përdoruesve ndaj bibliotekave dhe anasjelltas, janë objekt i trajtimit që u bën Gj. Berisha në punimin *"Përdorimi i bibliotekave dhe qasja në informata"*. Në vijim pasojnë shkrimet e Xh. Salihut *"Përkufizimi i veprimtarisë së bibliotekave publike"*, V. Veliut *"Biblioteka publike, lexuesit dhe shkrimtarët"*, S. Pirevës *"Në përpjekje të (mos) ndryshimeve në bibliotekat publike"*. Në kuadër të kaptinës studime, B. Baliu merret me trajtimin e veprave të Profesor Çabejt, me titull: *"Bibliografi e studimit të veprës së Profesor Çabejt në Kosovë"*.



Formati MARC 21 dhe Numri Standard Ndërkombëtar i Muzikës - ISMN, janë dy tema me rëndësi, të cilat janë përkthyer dhe përgatitur nga B. Kokollari, në kuadër të kaptinës Standarde.

Në kaptinën e Trashëgimisë, është paraqitur Rr. Rudi, me punimin *"Gjurmëve të një trashëgimie të shkatërruar"*, kurse për veprimtaritë bibliotekare paraqitën - S. Sadikaj *"Libërbusi në shërbim të komunitetit prizrenas"* dhe Xh. Luta *"Roli i bibliotekës "Përralla" në edukimin e fëmijëve"*. Në kuadër të infrastrukturës ligjore, I. Abdyl i bën një komentim ligjit të bibliotekave *"Ligji për Bibliotekat dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës"*, kurse redaksia boton të plotë, pa ndryshime, edhe *"Ligjin për Bibliotekat"*, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Punimet e kësaj reviste përmblyen me paraqitjen e disa botimeve të reja nga fusha e bibliotekarisë.

Kjo revistë, përveç karakterit shkencor e informativ, është edhe një manual për të gjithë punonjësit e bibliotekave, për faktin se një pjesë e konsiderueshme e punimeve do t'u shërbejë atyre gjatë punëve të përditshme. Merita për daljen e këtij numri, në veçanti, i atribuohet (përveç autorëve të shkrimeve e anëtarëve të redaksisë - për punën vullnetare në përgatitjen e revistës për botim) BKUK-së, e cila ka financuar daljen e këtij numri të revistës, pa ndihmën financiare të së cilës do të ishte e pamundur.

GJ. BERISHA

Në këtë numër



Naam Frashëri - poet i përveçëm
i kombit.....3

Në kërkim të periodikut të vjetër (III)6

Emërtimet lëndore në katalogët
e digitalizuar10

Bibliotekat speciale13

Prioritetet për definimin dhe vlerësimin
e disa problemeve bibliotekare.....14

BKUK po bëhet me sistem të automatizuar
të sigurisë së librit.....19

BIBLIOTEKA
KOMBËTARE
DHE UNIVERSITARE
E KOSOVËS



THE NATIONAL
AND UNIVERSITY
LIBRARY
OF KOSOVA

www.biblioteka-ks.org

Botues: BKUK • Kryeredaktor i botimeve: Dr. Sali Bashota

Kryeredaktor: Fazli Gajraku

Këshilli redaktues: Dr. Bahtie Gërbeshi-Zylfiu, Mr. Shukrie Rama,
Bedri Gashi, Gjon Berisha

Lektore: Hazbijë Qeriqi • Realizimi kompjuterik: Hekuran Rexhepi

Fotoreporter: Bashkim Binaku

Adresa: Sheshi "Hasan Prishtina", p.n. Prishtinë

Tel: ++381 38 225-605, Fax: ++381 38 248-940 • e-mail: biblioteka@biblioteka-ks.org

Naim Frashëri - poeti i përveçëm i kombit

Dr. SALI BASHOTA

1. SHËMBËLLTYRA

Emri i Naim Frashërit bashkë me veprën e tij rrezaton fuqishëm në artin e shkrimtarisë shqipe. Duke shpalosur kujtesën historike për imazhin e qartë të atdheut, edhe pas një shekulli, një pjesë e projektit të ëndrrës naimiane po bëhet realitet. Idetë letrare bashkë me fuqinë e lirikës së tij dhe thelbi i emocioneve lëvizin dhe ndriçojnë gjithnjë përbrenda madhësisë krijuese, aty ku atdhedashuria bëhet kryetemë për Idenë e Kombit.

Asnjë shkrimtar shqiptar në historinë e letërsisë shqipe nuk e ka fituar madhësinë e krijuesit sa Naim Frashëri. Poet, mendimtar, ideolog, me të drejtë është cilësuar apostull kombëtar dhe edukator i kombit.

Naim Frashëri është bërë ndriçues i mendjes shqiptare me frymëzimin e tij krijues, me idetë dhe temat e veprës së tij. Lirika e Naimit është fuqizuar përmes mallit suprem atdhetar dhe himnizimi i natyrës shqiptare ka mbërritur në shkallën më të lartë të adhurimtarisë dhe dashurisë.

Thelbësorja në veprën e Naimit është ringjallja e shpirtit shqiptar, mirësia dhe harmonia njerëzore.



Shëmbëlltyra e tij krijuese, personaliteti letrar e kulturor, ndërlidhen edhe me përhapjen e kulturës, qytetërimit, diturisë, arsimimit, dijes shkencore. Ashtu pandashëm vepra e tij funksionalizohet edhe me shtresimet e Iluminizmit në letërsinë shqipe të Rilindjes.

2. MADHËSHTIA KRIJUESE

Pas njëqind vjetësh, madhështia e Naimit sot na ofron te fakti i

poetit të përveçëm kombëtar që në sfondin historik e letrar është shndërruar në simbol – i mendjes më të ndritur të kombit.

Naim Frashëri plot një shekull qëndron në krye të elitës kulturore shqiptare. Ai u bë i famshëm, veçan me veprat: “Bagëti e bujqësija”, “Lulet e verësë” dhe “Istori e Skënderbeut”.

Gjithsesi, në studimet e sotme shqiptare kur flitet e shkruhet për veprën e Naim Frashërit, ndër të tjera, është trajtuar arti, filozofia, gjuha e poezisë së tij, pastaj relacionet me traditën poetike shqipe dhe me traditën letrare botërore. Një dimension të veçantë zë edhe doktrina e tij bektashiane. Fund e krye, dashuria, bukuria, mirësia bëhen figura themelore të poetikës së Naim Frashërit.

Në përkujtimin dhe nderimin e poetit kombëtar pas një shekulli figura e tij ndriçon në horizontin e së ardhmes shqiptare.

Duke u nisur nga realiteti kohor dhe kodi estetik pranues për madhësinë e Naim Frashërit domethënia kritike përqendrohet te vepra e cila dëfton për famën tejkohore të artit të tij që, para së gjithash, ka të bëjë me lexuesorinë masive si një libër udhërrëfyes (Bibël a Kur'an) për natyrën, kre-

narinë, heroizmin shqiptar. Këso mënyre, specifika e kërkimit të elementeve substanciale në veprën e Naimit mbështetet te tema e zgjedhur, te gjuha poetike, te shkëlqimi i fjalës shqipe ku parapëlqehet kodi ligjërimit që e sipërthekson atdhetarizmin.

Gjithkund në veprën e tij, Naimi e synon atdhetarizmin. Në temën romantike zgjedhet modeli që e përfaqëson atë: Shqipëria. Prandaj, Naimi është i papërsëritshëm me cilësitë e tij më të larta mendore si Shqipërikrijues. Kjo është pika më e përkryer e frymëzimeve, ideja që rilind e i dhurohet njeriut shqiptar. Pikërisht, nga ky zbulim poetik mbi bazën e ligjërimit lirik romantik pasionant funksionalizohet teoria e madhësisë dhe teoria e së bukurës. Sidoqoftë, fusha fatlume për ngritjen e Naimit në pedestalin e letërsisë shqipe, para së gjithash, është lirika atdhetare.

Thelbi, substanca e veprës naimiane qëndron në besimin e ideve burimore të cilat shtresohen

fuqishëm në dialektikën e ligjërimit të tij. Formulimi i mendimeve poetike për tërësinë e botës shqiptare i ka ushqyer simbolet naimiane të cilat e vëjnë në lëvizje harmoninë njerëzore dhe humanizmin. Prandaj, Naimi është edukator. Naimi është besimtar. Naimi është ideolog i bektashizmit. Ai me artin e tij poetik e formëson imazhin suprem për Shqipërinë. Naimi u këndon gjërave të thjeshta, shkruan në mënyrë mallëngjyese, nuk e admiron si temë-dilemë krijuese mjerimin, por lavdinë, heroizmin, mirësinë. Prandaj, Naimi ideolog dhe atdhetar, gjithmonë është shkrimtar i lavdishëm nacional i cili e ka ndërtuar filozofinë e tij letrare e besimore, pikërisht në ato tekste poetike të admirueshme, ku mbase Shpirti i Njeriut është i barabartë me Zotin.

Poeti e vizionon atdheun, mrekullohet me hyjnoren, e lartëson të bukurën, e përsos dashurinë njerëzore duke shkruar vepra për të gjithë shqiptarët. Dhe rëndësia qëndron prapë te tema. Në kuptimin poetik aty shtegton shpirti i poetit, kur është ëndërrues, projektues, besimtar, moralizues, himnizues, edukues apo njeri i vetmuar i cili e përballon dhembjen, vuajtjen, sëmundjen, por jo edhe robërinë.

3. VIZIONARITETI

Mund të flasim për idetë, për aktin e inspirimit, për vizionet, për mendimet filozofike, për doktrinën bektashiane, për rilindjen e shpirtit njerëzor, për teorinë

e receptimit e për referenca tjera, por prapë esenca qëndron te atdhetashuria. Kështu ndodh sepse rezultanta e ligjërimit naimian e shtreson imazhin mrekullitar të shpirtit njerëzor për të mbërritur absolutën e përfytyrimit (një lloj traktati) atë botë imagjinare përfytyruese si Shqipëria ideale, që tek Naimi ynë bëhet hiperbolë e letërsisë së formacionit stilistik të romantizmit.

Fuqia e himnizimit naimian e nxiti pasionin krijues për të përkryerën, për të përsosurën, për të përjetshmen duke e funksionalizuar edhe kujtesën historike, edhe vizionin e së ardhmes. Këtu, ndjenja është e pacënuar, ajo është e ngazëllyer dhe e trazuar herën tjetër dhe mundësia e shprehjes poetike qarkullon drejt idealitetit. Naimi nuk e kërkon lojën e figurave të letërsisë duke dënesur mbi realitetin e vrazhdë, edhe pse atdheu i tij është i pushtuar. Vlera përcaktuese e misionit të tij krijues është liria, ndërsa vlera përcaktuese e misionit të tij është mirësia. Dhe atdhetarizmi naimian prapë i rikthehet burimit ku thuret himni për atdheun, për dashurinë, për heroin kombëtar. Mirëpo, përmasa e himnizimit riciklohet për të fuqizuar gjithnjë imazhin suprem për Shqipërinë, prandaj thelbi i emocioneve të tij valëvitet nëpër shkallët e ligjërimit thirrmos e lavdës, atëherë kur fikcioni ngadhënjën mbi realitetin.

Motivet e tekstit naimian nuk i referohen iluzionit as pesimizmit, por besimit, vullnetit, virtutit njerëzor, apo teoremës personale. Kështu ndodh me teorinë e ligjërimit lirik e cila fuqizohet në trajtën më të admirueshme të ndjenjësimit



romantik, pikërisht te veprat: “Bagëti e bujqësia”, “Luletë e verësë” dhe “Istori e Skënderbeut”. Sipas Naimit, gjithçka është magjepsëse dhe mrekullitare: njeriu, natyra, dashuria, perëndia etj. Bota imagjinare e tij perceptohet në fushën ku lëvizin ndjenjat kryetipore që kanë të bëjnë me tematikën e preferuar. Aty ngadhënjën meditim filozofik. Aty shihen efektet estetike të një doktrine letrare, filozofike apo fetare e cila e saktëson burimësinë e saj, panteizmin, idealizmin apo bektashizmin që hulumtohen përmes artit poetik.

Himnizimi naimian sprovohet në variacione ligjërimore, jo vetëm kur përmendet atdheu, por edhe kur flitet për Bukurinë, Dashurinë, Perëndinë. Konceptet krijuese nxiten nga historia dhe emocionaliteti dhe fjala poetike funksionalizohet përmes ëndrrës, gëzimit, shpresës, ndërkaq profetizmi është çast lumturie dhe përsiatje tjetër shkrimore e filozofike që i ngjan ceremonisë së lavdeve. Kjo ka të bëjë jo vetëm me atdhetarizmin, por edhe me bektashizmin dhe frymën filozofike.

Në këtë kontekst, në veprën e Naimit himnizimi bëhet vlerë përcaktuese e shfaqjes së ndjenjave optimiste dhe mesazh edukativ e etik ku zotëron imazhi ideal dhe vizioni i Shqipërisë. Herën e parë është glorifikues, herën e dytë harmonizues, herën tjetër bëhet, doemos, mitizues. Në të gjitha nivelet e ligjëriminut parapëlqehet zgjimi, ringjallja e njeriut dhe e natyrës. Fund e krye, Naimi e shtreson lirizmin e tij magjepsës duke e fuqizuar gjithmonë formën gjuhësore dhe frymëzimin e zjarrtë që bashkarisht bëhen shpërblim të madhësisë.

Vargu poetik i Naimit nuk e krijon misterin e mosnjohjes, por aftësinë komunikuese deri në largpamësi. Naimi projektonte duke parashikuar. Ky modalitet e simbolizon inteligjencën e tij, gjithsesi, edhe vetë misionin prej poeti. Prandaj, është e kuptueshme domethënia e një fantazie të thjeshtë edhe nëse flitet për vizionaritetin si parabolë romantike.

Naimi e krijon mitin fatlum për njeriun shqiptar. Prapë parapëlqehet himnizimi si procedë, kur poeti e vazhdon përshkrimin për Atdheun, Dashurinë, Heroin kombëtar, Bukurinë, Perëndinë. Duke bërë zbulimin poetik për një jetë tjetër parajsore, Naimi gjithmonë detyrohet t'i rikthehet vetvetes, frymëzimit dhe ndjenjës shpirtërore për t'u identifikuar me të bukurën dhe idealen. Prandaj, iluminizmi i tij është dritë që triumfon mbi errësirën, është filozofi që valëvitet midis shqetësimeve që e kapërthurin ekzistencën e qenies.

Mos vallë një shekull është folur e shkruar më shumë për shëmbëlltërinë e Naimit, madje për atdhetarizmin e artit të tij apo për dritësimin e ideve se sa për vlerën konkrete të veprës. Kësisoj, atdhetarizmi është bërë detyrimisht vlerë përcaktuese, kur dihet se në pjesën tjetër të lirikës, Naimi është poaq i rëndësishëm. Duke u mbështetur në teorinë e receptimit, ai është shndërruar shpejt në mitin e kryepoetit. Gjithsesi, nga kjo formë e studimit edhe vetë Naimi është himnizuar. Kuptohet, kënaqësia e studiuesit gjithnjë është ekzagjeruar nga misioni krijues i poetit për fatin e kombit. Naimi, prandaj i përket ligjëriminut të një

realiteti të ëndërruar dhe bëhet mishërim i dijes, prijës shpirtëror i kombit dhe prijës i poetëve për të ardhmen parashikuese të letërsisë.

Naimi e ka pasuruar traditën poetike duke e favorizuar ruralen e duke kënduar këngën e lavdit për natyrën e bukur, veçan për Shqipërinë. Prandaj, morali i poezisë atdhetare ia ka ngritur famën. Gjithashtu, shkaktësia e ngjarjeve historike dhe pozicioni i kombit, jo rrallë, janë bërë tregues të vizionaritetit intelektual e krijues naimian, ndërkaq identifikimi me lëvizjen kulturore arsimore të Rilindjes kombëtare e ka kompletuar universin e tij krijues.

Synimi i Naimit ishte atdhetarizmi. Ëndërrimtaria poetike e Naimit ka nevojë të rimerret nga një kënd i ri i vlerësimit letrar. Naimi i glorifikuar deri sot do të nxjerrte rregulla të reja të analizës kritike e historiko-letrare nesër. Rrjedhimisht, vepra e tij funksionon në fondin e traditës më të çmuar poetike shqipe, veçan sa i përket efekteve nismëtare gjuhësore, rolit edukativ dhe funksionit dituror.

Platforma letrare e Naimit ishte Shqipëria dhe shqiptarizmi në përgjithësi. Shkëlqimi i fjalës poetike shqipe nuk do të kishte fuqinë as domethënien krijuese pa vargun brilant të Naim Frashërit që jorastësisht u bë edhe varg popullor. Vepra e tij dëshmon për dialektikën e lirikës shqipe, për imazhin e pastër të atdheut, për ringjalljen e optimizmit kombëtar, për projektet largpamëse që rrezatonin fatlumturinë më të përsosur të krenarisë kombëtare dhe vizionin për të ardhmen. Prandaj, Naim Frashëri, është poeti i përveçëm i kombit.

Në kërkim të periodikut të vjetër

(1848-1912)

(III)

GJON BERISHA

Përveç faqeve të gazetës, nga nr. 41 (1907) kjo gazetë botoi edhe një shtojcë me titull **"Kombi fletë letrare"** prej 4-faqesh. Gazeta vazhdoi të botohet deri në vitin 1908. Po në vitin 1906, shoqëria **"Dija"** në Vjenë, nën drejtimin Hil Mosit, në bashkëpunim me N. Ivanaj dhe Gj. Pekmezin, nxori revistën **"Kalendari i Shoknisë "Dija"**, botim i përvitshëm i ilustruar me lëndë shoqërore, kulturore, letrare, enciklopedike. Kalendari vazhdoi jetën e saj deri në vitin 1910.

Me iniciativën e kryetarit të shoqërisë **"Dëshira"** - Thoma Sotirit dhe nën udhëheqjen e redaktorit të saj Nikolla Lakos, në mars të vitit 1907, në Sofje, doli numri i parë i revistës **"Shqipëria"**. Kjo botohej si revistë e përmuajshme politike, shoqërore, letrare, kulturore, folklorike prej 8-faqesh. Janë botuar gjithsej 3 numra. Në numrin 3, që doli më 1 maj 1907, si duket ky ishte i fundit, **"Shqipëria"**, me një artikull, u angazhua kundër politikës austro-hungareze në Ballkan dhe konkretisht në Shqipëri. Revista **"Shqipëria"** sado që pak kohë doli, pati rëndësinë e vet dhe pati një rol të caktuar në propagandimin e shkollave në gjuhën shqipe dhe u angazhua për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare.

Në Trieste gjatë viteve 1907-1908, dolën dy tituj të periodikut shqiptar. Njëra quhej **"Dashamiri"**, numri i parë i së cilës doli më 14 nëntor 1907,

kurse i dyti **"Dashamiri i ri"**, numri parë i së cilës doli më 6 maj 1908 nën drejtimin e Mati Logorecit.

Gjatë viti 1908 dolën edhe këto të përkohshme: **"Lirija"** (1908-1910), gazetë e përjavshme në gjuhën shqipe, e cila botohej në Selanik nën drejtimin e Lumo Skendos (Mit-hat Frashërit); **"Besa"** (1908-1909) e përdyjavshme politike dhe shoqërore në gjuhën shqipe, e cila doli në Konstantinopoj (Stamboll), nën drejtimin e H. Frashërit; **"Bashkim"** (1908-1910), gazetë e përdyjavshme me lajme të kohës në gjuhën shqipe, numri i parë i së cilës doli më 8 nëntor 1908 në Stamboll nën drejtimin e Mihal Shan Tepelenës; **"Korça"** (1908-1910), gazetë e përjavshme politike, letrare dhe tregtare. Numri i parë doli më 28 dhjetor 1908 në Korçë dhe vijoi deri në nr. 53 më 1910, nën drejtimin e Sami Pojanit; gazeta **"Kosova"** (1908), e cila botohej në Shkup.

Nën drejtimin e Lumo Skendos (Mit-hat Frashërit) në fillim në Selanik e më vonë në Bukuresht, më 1 janar 1909 filloi botimin gazeta **"Dituria"**, e cila vijoi deri më 1929. Në vitin 1909, si organ i "Federatës Panshqiptare të Amerikës Vatra", filloi të botohet një ndër gazetatat më të njohura të shqiptarëve në SHBA me emrin **"Dielli"**. Numri i parë doli në Boston, më 15 shkurt 1909, në krye me Fan S. Nolin. "Dielli" disa herë pati edhe ndërprerje të shkurtra ose doli me tituj të tjerë, si: **"Dielli e Flamuri"**, **"Flamuri"**, **"Purteka"**,

"Kombi në rrezik" etj. Kjo gazetë, si më jetëgjata e shtypit shqiptar jashtë atdheut, gjatë 75-vjetëve të jetës së saj, ka ndërruar shumë botues, me bindje dhe pikëpamje të ndryshme politike e ideologjike, e si pasoj ka pasur luhatje të mëdha në qëndrimet ideo-politike.

Përveç gazetës **"Dielli"**, gjatë vitit 1909 dolën edhe shumë të përkohshme në gjuhën shqipe ose në dy gjuhë, si: **"Shqypeja e Shqypënis"** (1909-1911), numri i parë i së cilës u botua më 18 maj 1909 në Sofje; **"Zgjimi i Shqipërisë"** (1909-1911), gazetë dyjavore politike, shoqërore letrare në gjuhën shqipe, pjesërisht edhe në turqisht, numri i parë i së cilës doli më 1 qershor 1909 në Janinë; **"Lidhja Orthodhokse"** (1909-1910), gazetë e përdyjavshme politike, fetare e letrare nën drejtimin e Mihal Gramenos në Korçë; **"Shkumbi"**, (1909-1912), gazetë e përjavshme në gjuhën shqipe, e cila botohej në Stamboll në krye me Kasim Frashërin; **"Bashkimi i Kombit"** (1909-1910), gazetë e përdyjavshme politike e kulturore në gjuhën shqipe dhe turke, numri i parë i së cilës doli në Manastir më 10 shtator 1909 nën drejtimin e Fehim Zavalanit dhe Sali Cjukës; kalendarët **"Afredita"** (Manastir, 1909) dhe **"Korça"** (Korçë, 1909-1930); e përmuajshmeja **"Vatra"** (Minia, Egjipt, 1909); gazeta **"Shkodra"** (Shkodër, 1909-1910); **"Shqipëtar"** - Konstantinopol (Stamboll), - 1909-1910, gazetë e përjavshme politike, shoqërore e kultur-

ore në gjuhën shqipe, turke dhe frënge. Numri i parë doli më 31 dhjetor 1909, nën drejtimin e Dervish Himës dhe Hilë Mosit.

Në kuadër të botimeve periodike brenda territoreve shqiptare, një vend me rëndësi zë gazeta e përjavshme shkodrane në gjuhën shqipe "Koha", që shtypej në shtypshkronjën "Nikai", në Shkodër, që nga 1 janari 1910, e cila u drejtua nga D. Ndoc Nikaj. Nga nr. 2, kjo gazetë vijoi të dalë me emrin "Bashkimi", kurse përfundimisht u mbyll më 1911. Po në Shkodër, nga 2 tetori 1910 e deri më 1911, doli gazeta në gjuhën shqipe, "Dielli".

Gjatë vitit 1910, u botuan edhe disa tituj të tjerë të periodikut shqiptar, siç ishin: "Flamuri" (Boston, 1910), gazetë javore në gjuhën shqipe në krye me Faik Konicën; "Tomorri"



(Elbasan, 1910), e përkohshme e letrare në gjuhën shqipe me drejtor Lef Nosin; "Lahut'e Malsis" (Manstir, 1910), e përkohshme për kulturë, histori, folklor e lajme të kohës në gjuhën shqipe më drejtor Kristo D. Qirias, etj.

Një rëndësi të veçantë luajtën edhe botimet periodike në prag të Pavarësisë së Shqipërisë, respektivisht periodiku i viteve 1911-1912, në faqet

e të cilave pasqyroheshin ngjarjet e Luftërave Ballkanike dhe përpjekjet e popullit shqiptarë për liri e pavarësi nga zgjedha osmane. Gjatë këtyre viteve, u botuan gazeta e revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, ndër të cilat do t'i veçonim: gazetën javore "Koha" (Korçë, Xhejmstaun të SHBA-ve, 1911-1926) nën drejtimin e Mihal Gramenos dhe vëllezërve Mina e Koço Grameno; gazetën "Drita" (Manastir, 1911-1912), e përjavshme politike e shoqërore, në gjuhën shqipe dhe turke, e drejtuar nga Mustafa H. Leskoviku; "Liri e Shqipërisë" (Sofje, 1911-1915) gazetë e përdyjavshme në gjuhën shqipe, pjesërisht edhe greqisht e frëngjisht me drejtor Kristo Luarasin; "Trumbeta e Krujës" (San-Luis të SHBA-ve, 1911), gazetë e përdyjavshme kombëtare në gjuhën shqipe dhe angleze, dolën gjithsej 3 numra nën drejtimin e Faik Konicës; "Hana" (Shkodër, 1911-1912) gazetë politike e shoqërore në gjuhën italiane dhe pjesërisht edhe shqip me alfabetin e vjetër të Veriut; "Kalendari i Vjetës" (Shkodër, 1911-1927) kalendar vjetor që përmbante festat fetare dhe lëndë të ndryshme kulturore, historike, kronologji ngjarësh etj., në gjuhën shqipe e botuar nga kleri jezuit i Shkodrës; "Shkupi" (Shkup, 1911-1912), gazetë e përjavshme politike shoqërore në gjuhën shqipe, pjesërisht edhe turqisht, të cilën e drejtonte Jashar Erebera; "Kombi" (Manstir, 1911-1912); gazeta "Lajmëtari" (Sofje, 1911-1912) nën drejtimin e Kristo Luarasit; vjetari në gjuhën shqipe "Liberi i Përvjetshëm Shqiptari" (Stamboll, 1911) drejtuar nga Hil Mosi.

Nga botimet periodike, të cilat filluan punën e tyre në vitin 1912, do t'i veçonim: "Fiala e T'in Zoti" (Palermo, 1912-1915), revistë fetare e ritit grek (unit) në gjuhën shqipe (arbërisht) nga Hora e Arbëreshëve; "La Rivista dei Balcani" (Romë, 1912-1913), e përdy-

javshme e ilustruar në gjuhën italiane dhe pjesërisht edhe në shqip me drejtor Tarenc Toçin; "Atdheu" (Konstancë, Durrës, Shkodër, 1912-1914), gazetë e përdyjavshme në gjuhën shqipe, numri i parë i së cilës doli më 1 gusht 1912 në Konstancë - Rumani, kurse pas prillit 1914 'u shpërngul' në Shqipëri (në Durrës dhe Shkodër); "Zëri i Popullit" (Nju Jork, 1912-1913), gazetë e përjavshme në gjuhën shqipe, pjesërisht edhe anglisht, nën drejtimin e Krito Floqit dhe e fundit për këtë vit është Buletini Ndërkombëtar në gjuhën gjermane e frënge me emrin "Albanische Korrespondenz" (Vien, 1912-1918), e cila pasqyronte politikën austro-shqiptare dhe u shpërndahej shqiptarëve që gjendeshin në Austri.

SHËNIME:

Fjalor enciklopedik shqiptar, Tiranë 1985

T. Selenica, Shqipëria më 1937, Tiranë 1937

A. Kondo, Çështja Kombëtare në faqet e shtypit të Rilindjes, Tiranë [1982].

M. Gjinaj, Nga "L'Albanese d'Italia" (1848) te "Jehona e Tiranës" (1944), Tiranë 2003.

I. Dërmaku, Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe Kolonitë Shqiptare të Mërgimit në Rumani dhe në Bullgari, Prishtinë [1987].

P. Daka, Bibliografi retrospektive e shtypit periodik shqiptar e mbi Shqipërinë e viteve 1848-1944 (I. 1848-1908), Studime Historike, 3, Tiranë 1971.

P. Daka, Bibliografi retrospektive e shtypit periodik shqiptar e mbi Shqipërinë e viteve 1848-1944 (II. 1909-1919), Studime Historike, 4, Tiranë 1971.

Sh. Hoxha, Shtypi i kombeve dhe i kombësive të Kosovës (1871-1983), Rilindja, Prishtinë, 1987.

Sh. Hoxha, Shtypi shqiptar në luftë për autonominë politike dhe kulturore-arsimore 198-1910, "Shkëndija", Prishtinë, nr. 17-20 (1977), nr. 1-8 (1978)

M. Tërnavë, Çështja e botimit të gazetës "Zani i Shqiptarit", në Gjurmime Albanologjike - seria historike, 3/1973, Prishtinë 1975.

F. Behri, Kontributi i gazetës "Drita" të Shahin Kolonjës në vitet 1901-1908, në Studime për letërsinë shqiptare I.: Probleme të letërsisë shqiptare të Rilindjes Kombëtare, Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë, Tiranë 1981, f. 578-609.

Historia e Popullit Shqiptar II, Toena, Tiranë 2002.

Gazetat: "Fiamuri Arbërit", "Albania" e Brukselit, "Shqipëria" e Bukureshtit dhe "Kalendari Kombiar", Shqypëja e Shqypënis" e Sofies.

-fund-

Sema-soma e **LIBRIT**

/ vijon nga faqja 1/

Pati raste kur ndodhi edhe bashkëdyzimi i tyre, i shenjës arbitrare dhe asaj të motivueshme, dhe bota u pa si *Ikonë* (Pirs). Kësaj filozofie mund t'i shtohet edhe hetimi empirik se s'ka shenjë-libër apo koncept pa motivim?! Pse po themi se po e synojmë vetëm konceptin? *Libri* është *Botë*, ndërsa bota është libër, pra një ndërlidhni simbiotike që fshin arbitraritetet e shenjës e të hedh te konceptet e gjera motivuese. Po te cilat koncepte? Te ato koncepte që fuqishëm të shtyjnë të mendosh për botën e *Librit*, (Blansho) botën e fenomeneve, në të cilën do të përfshiheshin stivat e gurëve të gdhendur që e formësuan *Epin e Gilgameshit*, pastaj vallet për nder të Perëndisë Dionis, që e lindën Teatrin antik a *tragjedinë*, pergamenët e shumtë që u ruajtën në errësirën e Mesjetës e i dhanë dritë Renesancës, për të kaluar në formacionet e ndryshme të dijeve deri në modernitet, ku ndërlidhnia dhe interkomunikimi tashmë ka ndikuar që gjithçka të shihet në rrjet, në një rrjet që edhe arkitekturën, pikturën, teknikën e virtualen i bën gjuhë komunikimi, i bën libër, për t'i futur fuqishëm në *Botën* simbiotike të *Librit*, të një *Libri*, që, shikuar në një plan më të gjerë josimplifikues, përzihen natyrat, materiet, zhanret, kodet, zërat, ngjyrat e shkronjat etj., nga të cilat pastaj reflektohet bota reale dhe bota metafizike. *Libri* shndërrohet në fizikë dhe metafizikë, besim e mosbesim, errësirë e dritë, realitet e idealitet, mësim e dogmatizëm, shndërrohet në imanencë të

utopisë së kërkimit në këtë Botë duke e synuar një Botë tjetër, pra botën që projektohet nga po ky Libër. Pra, jemi në vorbullën e *Librit!*

Libri është jeta në tokë, *Libri* është jeta në *Përjetësi*, sepse nëpërmjet tij projektohet ajo. Cila, atëherë, do të ishte vlera e librave fetarë?!

Sipas kësaj filozofie, mund të themi se ekziston libri i Platonit, libri i Aristotelit, libri "i errët" i *auktorëve* të Mesjetës, libri i humanistëve të Renesancës, etj., për ta simplifikuar ose arbitrarizuar këtë koncept e për të thënë se ekziston tashmë edhe libri i Borhesit, Kafkës, Ekos e Pashkut, si veçanti natyrash e diskursesh etj., (Todorov).

Kjo ndërlidhni nuk ndalet këtu, por mund të vazhdojë e të përfshijë në vetvete edhe *Librin* e gjithë mimetikës njerëzore, pra atë që lë ndonjë shenjë, nëpërmjet shkrimit, por edhe atë që nuk i hetohen shenjat. Të gjitha këto libra sillen e mbështillen në kuadër të një *Libri* që njëjtësohet me *pakufishmërinë universale*. Kjo ndoshta është edhe ideja e mimetikës njerëzore që bartet në jetë e në tekste, në një proces të riciklueshëm të gjallimit njerëzor. Pra, ky *Libër* (imagjinativ) po u përbëka nga librat-shenja, të cilat dalin nga po ky *Libër* (*Botë*) si imanencë e gjallimit tonë në këtë rruzullim!

Prandaj, sipas kësaj del se libri-shenjë mund t'i përkasë një periudhe parahistorike a historike, një "zemani" mitologjik që ka lënë mbrapa gjallë mitet, një identiteti nacional e shoqëror, një grupi autorësh që e kanë shënuar një frymë, një autori që ka pjellë një

veçanti të të menduarit, por edhe një njeriu që e ka ndjerë ose e bartuar një shenjë a një dhembje të kësaj shenje mimetike jetësore veçuese. Ndoshta del tepër arbitare, por zurrkajat e mendimit më thonë se *Librin* e ndiejnë ata që kanë hyrë në botën e tij, por edhe ata që s'e njohin e ndoshta edhe s'e duan këtë botë, por merren vetëm me pasojën e saj. *Libri* pjell libra, e librat e ushqejnë, përbëjnë *Librin*. Bota identifikohet fuqishëm me *Librin*, ndërsa ne merremi dhe përplotësojmë këtë *Identifikim* me copat dhe grimcat që i marrim nga po ky Libër. Operojmë me thërrimet që pëlcastin nga po ky Libër. Kjo assesi nuk duhet të shihet si një përsiatje teologjike, as si një rusoizëm ekstrem, ose mohim i logosit si imanencë e trurit njerëzor, por vetëm si një përpjekje për ta hetuar fuqinë e *Librit* dhe kërkesën e tij. *Libri* është Një, analogjikisht me Zotin që është Një, ndërsa libra ka dhe do të ketë aq sa do të gjenerojë po ky Libër?! Nëse lexojmë ose mbledhim libra, s'kemi bërë asgjë më shumë sesa që kemi njohur përvoja e shenja të *Librit*, shenja të cilat po të simplifikohen mund të shihen edhe si shenja që një lexues i heton në krijimtarinë e Borhesit, Kafkës, Xhojsit e Pashkut, pra një lexuesi që i heton librat e këtyre autorëve.

Njerëzit, në këtë rast lexuesit, këto lexime librash i marrin e i shohin vetëm si shenja të një kohe, një referencë ndaj *Librit* dhe thuajse për këtë shkak kanë mbetur gjallë stivat e gurëve, pergamenët, skriptoret, shkollat e bibliotekat me qëllim që të ruhen e përkthehen copa librash e


copa kohësh nga po ky Libër. Një shkollë a bibliotekë shquhet nëse arrin të mbledhë sa më shumë copa, libra-shenjë të këtij *Libri* dhe t'i ruajë me kujdes në errësirën e dritës reflektuese të saj. Kjo punë mund të cilësohet si një utopi e hijshme, sepse nëpërmjet saj tentohet të dokumentohet dhe të matet koha e *Librit*, koha drejt një kohe që ecën riciklueshëm nëpër shpërndërrimet e vazhdueshme të saj. Vështirë të projektohet matja e kohës së *Librit* a atributi i elementit kohë ndaj këtij *Libri*. Kjo thajse është edhe lufta për iluzionin e jetës së shenjave në kuadër të këtij *Libri*. Nëse do të

hynim në botën e simplifikimit në kuadër të këtyre shenjave-libra do të kishim shenjat personale, nacionale e universale, por gjithnjë në vorbullën e ruajtjes së shenjës-kohë në udhën e *Librit*, që njëkohësisht është edhe ruajtja e udhës së Botës. Udhë e iluzionit jetësor e imagjinar përjetësues.

Ndërsa ne, lexuesit (njerëzit) përbërës të kësaj bote, ecim së bashku në këtë udhë, në këtë udhë që i nënshtrohet *diferancës* së *Librit* dhe *dekonstruksionit* (Derrida) të tij. Prandaj, edhe dekonstruksioni është parë si gjithçka dhe asgjë! Sa më shumë që të arrihet në ruajtjen

dhe riciklimin e shenjave-libra aq më shumë do të arrihet në njohjen e *Librit* dhe njëkohësisht edhe të ballafaqimit real e ditor me të. Copa të këtij *Libri* gjenden nëpër mendjet tona, duart tona, arealin tonë fizik e shpirtëror, shkollat tona, por veçanërisht nëpër bibliotekat tona, të cilat ruajnë shenja-libra të paçmueshëm, për t'u bërë edhe vetë pikë, ose thënë kushimisht atome të *Librit* (*Botës*) universal(e). Sa më shumë shenja-libra aq më shumë njohje për *Librin*, prandaj nuk është rastësi investimi në ruajtjen, përceptimin dhe riciklimin e këtyre shenjave, dhe veçanërisht nëpër vende ku librat-shenja flasin e shukasin për *Librin*. A thua, po të simplifikohet "problematika", a mund t'i atribuohet gjithçka një *Biblioteke*, një bibliotekë që jeton në riciklimin e shenjave të librave. A mund të merret kjo si shenjë se pse është gjithë ajo dëshirë për gjetjen, ruajtjen, jehonën, pra konservimin e të gjitha shenjave-libra, që nga *Epi i Gilgameshit*, bile edhe para tij, e deri në ditët e sotme. Ky proces riciklues e qarkullues a thua bëhet për ta njohur sa më shumë *Librin* alias *Botën*. Thënë shkurt e trup varri ruan gjithçka, prandaj a do të mund të quhej *biblioteke* një varr reflektues (*sema-soma*) ku ruhet dhe riciklohet dija për *Librin* alias për *Botën*?! Mbase, kjo do të ishte tendenca e kësaj biblioteke-varr, edhe nëse gjithçka do të mbetet në vorbullën e utopisë. Do të dëshiroja që bibliotekat të ishin varre, që do të të shashtisnin me errësirën, nga e cila, sikur nga një minierë, pastaj të burojnë dije e pasion për të, për ta njohur e rinjohur *Librin* alias *Botën* nëpër të cilën po kapërcejmë.

(tutor, 2005)



Emërtimet lëndore në katalogët e digjitalizuar

Një ndër çështjet profesionale që kërkon vëmendje të veçantë në të ardhmen në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, me funksion të veçantë në programin e automatizuar bibliotekar - ALEPH 500, është edhe fusha e *Emërtimeve Lëndore*. Ideja për trajtim të këtij problemi në këtë shkrim është e motivueshme. Klasifikimi i materialit bibliotekar, përkatësisht - *Emërtimet lëndore*, tashmë praktikisht është duke u bërë. Kjo ka imponuar hulumtim të literaturës përkatëse, në vijimësi, si dhe përcjellje të trajtimeve nga fusha e klasifikimit lëndor; tash së fundi janë mbajtur trajnime në këtë fushë për stafin e BKUK-së në Prishtinë e në Tiranë, në të cilat janë trajtuar tema specifike nga kjo fushë.

Meqë, tashmë BKUK-ja ka filluar ta zbatojë klasifikimin lëndor, është përgjegjësi e stafit profesional të bibliotekës që të veprojnë në përputhje me dijen teorike që ka zhvilluar kjo fushë. Përpjekjet tona për ta përvetësuar sa më mirë këtë dije, si teori dhe si praktikë, do të jenë në dobi të përdoruesve në të ardhmen.

KËRKIMET BIBLIOGRAFIKE

Identifikimi i shpejtë i veprës, lehtësia e kërkimit dhe skemat e përcaktuara janë veçoritë moderne të klasifikimit lëndor. Kërkimet bibliografike përveç renditjeve me autor, me titull dhe sipas KUD-it, mund të

kenë edhe renditje tematike të materialeve. Këtë e ofrojnë katalogët e bibliotekave dhe mjetet e tjera të kërkimit përmes katalogimit sipas subjektit. Përdoruesi kërkon informacion për një subjekt, përmes të cilit i identifikon veprat që i përkasin një teme të caktuar. Andaj, për t'i plotësuar më mirë kërkesat e përdoruesve bëhen përshkrimet sipas subjektit, sepse jo gjithmonë titulli i veprës e shpreh qartë përmbajtjen e saj.

Mënyrat e kërkimit sipas subjektit janë pothuajse të ngjashme me ato të programit Aleph 500. Kërkimi bëhet nëpërmjet fjalëve që përbëjnë titullin (fusha 100) dhe fjalëve në fushën e shënimeve të përshkrimit bibliografik. Derisa në katalogët me skeda dhe në mikroformë, kërkimi sipas titullit është i kufizuar vetëm me fjalën e parë të tij, në katalogët e kompjuterizuar, përdoruesi mund të përdorë çdo fjalë të titullit ose të përmbajtjes. Dhe, kur përdoruesi dëshiron një informacion, sa më të plotë, të një subjekti të dhënë, ai duhet të kërkojë sipas sinonimeve rreth atij subjekti. Kështu, p.sh. nëse kërkon me subjektin STUDIME, atëherë do të dalin të gjitha veprat, që në përmbajtjen e tyre kanë termat STUDIME. Mirëpo, ka shumë tituj që nuk kanë në përbërje të tyre fjalë që shprehin subjektin. Kjo ndodh më shpesh në veprat e shkencave humanitare dhe sociale.

Ekziston edhe një mënyrë tjetër e kërkimit sipas subjektit. Kjo është sipas

fjalorit të kontrolluar (Klasifikimi Lëndor; dorëshkrim i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, f.1). Këtu, për çdo regjistrim ose përshkrim, zgjidhen fjalë dhe fraza të veçanta, si terma lëndore, ku çdo term përfaqëson vetëm një subjekt. Të gjithë këta terma formojnë një fjalor të kontrolluar.

Tipat kryesorë të fjalorëve të kontrolluar janë *skemat e klasifikimit bibliografik* (KDU, KDD, etj.); *lista e emërtimeve lëndore* dhe *tezaurët*, në të cilët termat paraqiten në renditje alfabetike dhe sistematike. Renditja alfabetike e termave në *skemat e klasifikimit bibliografik* është sekondare dhe paraqitet në formë treguesi, kurse ajo është parësore në *Listën e Emërtimeve Lëndore* dhe në *tezaurë*.

KLASIFIKIMI, KATALOGIMI LËNDOR DHE INDEKSIMI LËNDOR - FUNKSIONI I TYRE

Në bibliotekari përdoren tre terma: *klasifikim, katalogim lëndor* dhe *indeksim lëndor*.

Termi *Klasifikim*, bazuar në sistemin përkatës (KUD, KDD, etj.) ka të bëjë me përcaktimin e numrit të klasifikimit të veprave, që do të thotë se shprehet me numra, 0-9.

Termi *Katalogim lëndor* shpreh përmbajtjen e një njësie bibliografike duke përdorur *Emërtimet Lëndore*. D.m.th. derisa *Klasifikimi* sipas KUD-it shprehet me numra, *Emërtimet Lëndore* shprehen me fjalë.

Një njësi bibliografike, përmes *Emërtimeve Lëndore*, mund të shprehet me emrin e një koncepti, personi, grupi, objekti, vendi etj. Kur vepra flet për një person ose për një organizatë, si EL përdoret edhe një emër personi ose emër institucioni a organizate. Dhe, forma e EL kur shprehet me emër personi është e njëjtë me përcaktuesen kryesore të shprehur me autor: p.sh. kur një libër flet për jetën dhe veprën e Ismail Kadaresë, forma e EL do të jetë *Kadare, Ismail*. Pra, në të njëjtën mënyrë siç përdoret përcaktuesja kryesore e përshkrimit bibliografik të ndonjë vepre të Ismail Kadaresë.

Në *Katalogun lëndor*, puna e parë dhe e domosdoshme është që të bëhet përcaktimi i saktë i subjektit të veprës. Dhe kjo, jo gjithmonë është e lehtë, sepse subjekti i një vepre shpeshherë nuk përcaktohet menjëherë në titull. Bile ka raste kur, pikërisht, titulli të ngatërron me subjektin e veprës.

Gjetja e EL për përcaktimin e subjektit të një vepre është e njëjtë sikur te KUD-i.

Termi *Indeksim lëndor* ka të bëjë me paraqitjen e subjektit të pjesëve të një njësie bibliografike, p.sh. indeksit lëndor, që përmban një libër në faqet e fundit.

Si mjet i indeksimit lëndor është *tezauri* - listë e termave të kontrolluar. Në të pasqyrohen edhe lidhjet ndërmjet termave. Këto lidhje paraqiten me simbolet TGj (Term i gjerë), TN (Term i ngushtë), SI (Sinonim) dhe TL (Term që lidhet me ...). Standardet ndërkombëtare si NISO 1998 (National Information Standards Organization), ISO 1986, ISO 1985 (International

Organization for Standardization) janë marrë me ndërtimin e tezaureve njëgjuesh dhe shumëgjuesh.

EMËRTIMET LËNDORE

Në katalogët e automatizuar të bibliotekave, ose edhe me skeda, forma më e përdorur për përcaktimin e subjektit të materialeve bibliotekare po bëhet *Katalogimi lëndor* dhe termat e tillë quhen *Emërtime Lëndore*, e që janë të organizuar në një *listë të emërtimeve lëndore*. Listat e tilla hartohen nga bibliotekat ose nga institucionet e tjera të përafërta. Deri tani, Biblioteka e Kongresit, LCSH (Library of Congress Subject Headings), ka hartuar listën më të plotë, e cila ribotohet çdo dy vjet, me shtesa dhe korrigjime. Andaj, si e tillë, ajo është përkthyer dhe vazhdon të përkthehet nga disa biblioteka të vendeve të Evropës. Biblioteka Kombëtare e Tiranës e ka krijuar listën e saj duke përkthyer Sears List of Subject Headings. Kjo listë është rekomanduar për biblioteka publike, me fonde mesatare, me plotësime të nevojshme për probleme që lidhen me Shqipërinë. Natyrisht, edhe Kosova duhet t'i përdorë metodat e unifikuara të *Emërtimeve Lëndore (EL)*. Zgjerimi i listës së Treguesit të Emërtimeve Lëndore bëhet, më së miri, me marrjen e emërtimeve nga LCSH, duke i përkthyer e përshtatur ato në shqip. Mirëpo, ekzistojnë rregulla të caktuara, në të cilat duhet të bazohet zgjedhja e emërtimeve dhe paraqitja e tyre në


tregues. Rregullsia në katalogun lëndor sigurohet duke i zbatuar këto rregulla.

Se çfarë materiale ka biblioteka, për një subjekt të dhënë, tregon *Katalogu lëndor*. Dhe, pavarësisht nga terminologjia që është përdorur në vepra të ndryshme, që i përkasin atij subjekti, ato mbliidhen në një emërtim lëndor.

Ka edhe raste kur disa objekte kanë më shumë se një emër (rasti i sinonimeve). Atëherë, pavarësisht nga emrat e përdorur nga autorët, njëri prej tyre zgjidhet si *Emërtim Lëndor*, për t'i paraqitur të gjitha materialet që i përkasin atij subjekti.

P.sh.: *Emërtimi Lëndor Erërat* është zgjedhur ndërmjet fjalëve *Era* dhe *Stuhitë*.

Mandej, ka shumë koncepte që shprehen në mënyra të ndryshme dhe si *Emërtim Lëndor*, i të gjitha këtyre, zgjidhet vetëm njëri nga termat e mundshëm dhe paraqitet në një



formë të vetme. P.sh. fusha e mjekësisë mund të shprehet me terma të ndryshëm (mjekësia, shëndetësia, etj.), dhe nëse marrim një koleksion me 15 libra, të këtij subjekti, përshkrimet e tyre, të secili term, mund të renditen në mënyrë të përsëritur. Mirëpo, një gjë e tillë mund të shkaktojë probleme në mbajtjen e rregullit. Andaj, duhet zgjedhur termin më të përdorshëm si parim të emërimit uniform.

Te emërtimet me nënndarje, ka përjashtime për praktikën e përdorimit të emërimit uniform. P. sh.:

Kosova – Marrëdhëniet me jashtë – Zvicra
Zvicra – Marrëdhëniet me jashtë – Kosova

Siç shihet, këtu dallon elementi hyrës, përndryshe emërtimet përbajnë të njëjtat fjalë.

ZGJEDHJA E TERMAVE NË TREGUESIN E EMËRTIMEVE LËNDORE

Ekzistojnë disa mënyra të zgjedhjes së termave, e ato janë:

Zgjedhja ndërmjet termave që janë sinonime;

Zgjedhja ndërmjet termit shkencor dhe

atij popullor;

Emërtim i vetëm.

1. *Zgjedhja ndërmjet termave që janë sinonime* – bëhet në atë mënyrë që termi i zgjedhur të jetë më i përdorshëm dhe të mos ketë shumë kopime. Këtu mund të ketë problem me termat e përafërt, sepse ka subjekte që nuk janë të njëjtë, por kanë lidhje të ngushtë ndërmjet vete. Këta terma, së bashku, mund të vendosen nën të njëjtin emërtim.

2. *Zgjedhja ndërmjet termit shkencor dhe atij popullor* – bëhet, në përgjithësi me terma popullorë (nëse janë më të përdorshëm). Mirëpo, te emrat e kafshëve dhe të bimëve në shumë raste përdoret emri latin.

3. *Emërtim i vetëm* – bëhet kur subjekti ka një emër të vetëm. P.sh. fushat e diturisë shprehen me një fjalë të vetme (*Arti, Muzika, Edukimi etj.*), pastaj objektet e ndryshme (*Molla, Kitara etj.*). Mirëpo, nëse subjektet e ndryshme kanë të njëjtin emër, atëherë ato dallohen me anë të cilësorëve. P.sh. : *Të ftohtit dhe Të ftohtit* (Sëmundje).

EMËRTIMET - NË SHUMËS DHE NË NJËJËS

Numri shumësi përdoret për objekte konkrete ose për kategori të caktuara njerëzish (p.sh.: *Bibliotekat; Fëmijët*). Mirëpo, këtu ka edhe përjashtime. P.sh. te emrat e frutave numri njëjës përdoret si për frutën ashtu dhe për pemën. (p.sh.: *Molla; Dardha etj.*)

Numri njëjës përdoret për koncepte ose ide abstrakte. P.sh. Emërtimet që tregojnë specie biologjike, në përgjithësi janë në njëjës. Ndërkaq, kur për një emër përdoret edhe njëjësia edhe shumësi, ata përfaqësojnë subjekte të ndryshëm. P.sh. *Ngjyra* si fenomen fizik dhe *Ngjyrtat* në pikturë.

EMËRTIMET E PËRBËRA

Emra të njëjtë që dallohen në përmbajtje ka shumë dhe në tregues ka mënyra të ndryshme për t'i dalluar ata. Një mënyrë e tillë është edhe termi i përdorur në formë fraze. P.sh.: *Biografia* (për biografitë kolektive) dhe *Biografia si formë letrare*.

Fraza përdoret edhe kur një objekt nuk mund të shprehet vetëm me një emër të vetëm. Frazat përbëhen nga: emër dhe mbiemër (p.sh. *Analiza matematike, Pemët frutore etj.*); emër dhe mbiemër që tregon etni, kombësi (p.sh. *Poezia shqipe*); dy emra (p.sh. *Katalogët e bibliotekave*); emërtime që tregojnë rolin e një klase njerëzish në një veprimtari ose profesion (p.sh. *Fëmijët artistë*) etj. Dhe, këto emërtime quhen të përbëra. Mirëpo, përveç tyre, formohen edhe fraza që quhen të lira dhe të cilat nuk i përmban treguesi, por krijohen nga kataloguesi sipas nevojës. P.sh. në art ose në letërsi trajtohen subjekte të ndryshme. P.sh. *Fëmijët në letërsi; Gratë në art etj.*

-vijon-

Përgatiti: Hazbije QERIQI

Full View of Record	
Choose format:	Standard Caid catalog Citation Name tags MARC tags
Book Number	00001809
Record Format	Monograph
Main Entry	● Bicoku, Kasem
Title	● Gjergj Kasbioti Skënderbeu - bibliografi, 1404-1405 / Kasem Bicoku, Jup Kasrati.
Imprint	[Tiranë] : Biblioteka Kombëtare, [1997]
Descr.	Libri 1. : ilustr. ; 24 cm
Language	alb
Gen. Note	Parathënie / Dhimitër S. Shuteriqi, Mërk Dorri. : f. 9-49
Bibliogr.	Treguesit : f. [379]-488
Contents	[Libri] : Bibliografi 1404-1405
Per. Sub.	● Skënderbeu, 1405?-1408 - Bibliografi ● Skënderbeu 1405?-1408 - Bibliografi
Add Entry	● Kasrati, Jup
Add Entry	● Biblioteka Kombëtare

Shembull nga Klasifikimi Lëndor në katalogun elektronik të BKUK-së

Bibliotekat speciale

Dr. BAHTIE GËRBESHI - ZYLFIU

Ky shekull, në të cilin sapo kemi hyrë, kërkon një politikë dhe një strategji kulturore shumë më efektive se ajo që është ndjekur deri tash. Përcaktimi dhe formulimi i një strategjie të qëndrueshme kulturore e bën të domosdoshëm faktin se institucionet kulturore në Kosovë duhet të pësojnë transformime radikale. Sikurse edhe të gjitha institucionet e tjera edhe bibliotekat janë të përfshira nga valët e ndryshimeve të mëdha shoqërore, ekonomike, teknologjike dhe kulturore.

Zhvillimi i sotëm teknologjik ka përfshirë edhe një lloj të veçantë bibliotekash – bibliotekat speciale. Qëllimi kryesor i këtyre bibliotekave, sikurse edhe i bibliotekave të tjera, është që t'u shërbejnë përdoruesve të materialeve bibliotekare, edhe pse këto biblioteka funksionojnë pak më ndryshe.

Në shumë vende të botës, bibliotekat speciale janë grupe bibliotekash nga më të shumtat dhe më të ndryshmet, të cilat është mjaft vështirë t'i identifikosh.

Shumësia e tyre është e ndryshme. Ajo sillet prej një fondi të vogël, të vendosur në një zyrë të një firme komerciale e deri te bibliotekat e firmave të mëdha industriale ose ministrive shtetërore me fonde dhe degë të shumta të shkencës dhe teknikës. Në këtë grup janë edhe disa biblioteka të shkollave të larta, të cilat, për shkak të natyrës së ngushtë të fondeve, kanë fokus lëndor të vogël, më tipik për biblioteka speciale sesa për ato universitare.

Specializimi i ngushtë lëndor është karakteristikë e këtyre fondeve. Fondi plotësohet vazhdimisht me materiale. Në përgjithësi, njësitë në pjesën e fon-



dit të dedikuara për punë zakonisht nuk janë më të vjetra se 25-30 vjeç, edhe pse mund të ruhen edhe materiale diçka më të vjetra, të cilat janë të vendosura nëpër depo dhe qasja në këto materiale është e kufizuar. Gjithashtu, një përqindje të madhe të fondit e përbëjnë revistat – deri në 80% në bibliotekat e drejtimit shkencor ose teknik. Sikurse në bibliotekat e tjera, edhe te bibliotekat speciale, fondet shpesh karakterizohen me një përqindje të dukshme të materialeve në gjuhë të huaja. Pra, këto lloje bibliotekash karakterizohen me madhësinë e tyre të kufizuar – tipike për këto biblioteka.

Në rastet më të shpeshta, në bibliotekë është i punësuar vetëm një profesionist informator. Bibliotekari zakonisht është ekspert për lëndën përkatëse, qoftë sipas edukimit të tij ose njohurive të arritura nëpërmjet praktikës, pasi që paramendohet që eksperti me njohje të mira të lëndës është ai që më së miri do t'i kuptojë kërkesat e lexuesve - kërkesat e tyre për

informacione. Këta ekspertë, sikurse kolegët e tyre në bibliotekat e fakulteteve në shumë raste i pranojnë mendimet apo kërkesat e lexuesve për titujt, të cilat duhet të sigurohen (blihen).

Për dallim prej kolegëve në bibliotekat e tjera, këta nuk mund ta shfrytëzojnë ndihmën e mjeteve standarde për zgjedhjen e materialeve, sepse ato ose nuk janë mjaft të specializuara, ose nuk janë mjaft azhure. Për këso fondesh studioze, rol të rëndësishëm gjatë zgjedhjes kanë informatat e botuesve dhe të furnizuesve dhe burimet e indeksimit dhe abstrahimit.

E fundit, por dhe më e rëndësishmja, për zgjedhjen e materialeve për bibliotekat speciale, është mbështetja në njohjen personale, shpesh joformale, të kërkesave të përdoruesve për informacione.

Duke pasur parasysh se përdoruesit janë ekspertë të profileve të ngushta, ai i cili disponon me informata gjithësi arrin pasqyrë të qartë dhe të hollësishme të nevojave informative, të secilit përdorues shumë më shpejt sesa në ndonjë mjedis tjetër informativ.

Në bibliotekat, që ofrojnë shërbime informative të specializuara, duke përfshirë kërkimet e rregullta elektronike direkte dhe shpërndarjen e informatave të selektuara, definimi i përdoruesve mund të jetë pjesë e procedurës zyrtare; në rastet e tjera ky është rezultat i kontaktit të përditshëm të bibliotekarit me përdoruesit.

Duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë që kanë bibliotekat speciale, mbetet detyrë e shoqërisë sonë që këtyre bibliotekave t'u kushtojë kujdes të veçantë, sikurse shoqëritë e tjera moderne, të cilat u japin vend të merituar – pra këto biblioteka duhet të bëhen qendër e informacionit për institucionin të cilit ato i takojnë.

Prioritetet për definimin dhe vlerësimin e disa problemeve bibliotekare

BEDRI GASHI

Nga ekspertë dhe punëtorë bibliotekarë, vendës e të huaj, që merren me çështje të veprimtarisë së bibliotekave, janë parashtruar një sërë iniciativash dhe sfidash për zhvillimin modern të bibliotekave në Kosovë. Më të njohurat, deri tash, janë prezantimet e Grant Harrisit, specialist i shënimeve të Bibliotekës së Kongresit Amerikan. Përmbajtja e sfidave të parashtruara nga Grant Harrisit duhet të vlerësohet nga pikëpamjet e së ardhmes së Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, por edhe të së ardhmes së bibliotekave të tjera në Kosovë. Sipas tij, detyrat themelore të një biblioteke kombëtare përmbledhen rreth tri elementeve kryesore: mbledhja, ruajtja dhe kontrolli bibliografik i materialeve bibliotekare.

Kujdesi i lartë shoqëror ndaj bibliotekave në vendin e madh të Grant Harrisit – në SHBA, për një vend si Kosova, është mësim që jep përgjigje për shumë çështje që lidhen me përparimin e veprimtarisë bibliotekare. Për rolin dhe rëndësinë e tipit publik të bibliotekës, Harris, nga një pikëshikim pragmatik thotë: ç'është mirë për Prishtinën është mirë edhe për Pejë, Prizrenin dhe Prekazin.

Ndërtimi i bashkëpunimit të ngushtë i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës me bibliotekën më të famshme në botë - Bibliotekën e Kongresit Amerikan, shënon raportet më miqësore të BKUK-së me ndonjë bibliotekë në botë. Me një ndjenjë tejet miqësore, gjatë një fjale rasti, Grant Harris inkurajoi për punën që po bëhet në BKUK, kur tha: "Dr. Sali Bashota

është për t'u lavdëruar për përpjekjet e tij të shpejta në përcaktimin e një date për ngritjen e fondeve dhe për përmirësimin e pajisjeve të Bibliotekës Kombëtare. Ne në Bibliotekën e Kongresit ju dëshirojmë sukses dhe shpresojmë që të punojmë së bashku. E di se nuk keni mundësi që t'i zbatoni të gjitha menjëherë; asnjë bibliotekë nuk mund ta bëjë këtë. Biblioteka juaj tashmë është një simbol i kulturës dhe e tëra kjo është një gjë e mirë. Se çfarë jam duke sugjeruar është se çdo bibliotekë kombëtare përpiket që ta forcojë dobishmërinë, relevancën dhe kuptimin e bibliotekave kombëtare - këtyre institucioneve kryesore - në këtë milenium të ri".

Në aspektin e ofrimit të shërbimeve të një niveli të lartë për përdoruesit, duhet shfrytëzuar përvojën e madhe amerikane dhe ndihmën e miqve amerikanë për bibliotekat e Kosovës, që tashmë na është ofruar, duke u dhënë përgjigje shumë sfidave, si: roli udhëheqës i Bibliotekës dhe menaxhimi i saj, depozitimi i materialeve bibliotekare, digjitalizimi i materialeve të zgjedhura etj.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës edhe më tej mbetet brenda konceptit të dy cilësorëve – kombëtare dhe universitare, si strehë e trashëgimisë së përgjithshme dhe asaj universitare. Ndarja e bibliotekës në kombëtare dhe universitare është një proces profesional e teknik, që nënkupton edhe investim në infrastrukturë. Dytipëshi i tashëm kombëtar dhe universitar i bibliotekës përmbledh dhe organizon strukturën e liter-

aturës periodike dhe monografike në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e huaja, si dhe materialet e tjera jolibër.

Sipas koncepteve moderne bibliotekare, do të duhej të trajtohej ndryshe e ardhmja e këtyre dy institucioneve bibliotekare - kombëtarja do të ishte depozituese e të gjitha llojeve të materialeve bibliotekare, ndërsa - universitarja do të klasifikonte llojet e materialeve në përputhje me nevojat studiuere, kërkimore dhe shkencore (Oberembt). Nëse vërtet kujtojmë promovimet e botimeve kombëtare, udhëheqjen e rrjetit kombëtar të bibliotekave, bashkëpunimin me strukturat ndërkombëtare dhe çështje të karakterit të ngjashëm kulturor, arsimor e shkencor, mund të themi se veprimtaria e një biblioteke kombëtare është kapitale për një vend. Po që se e rishikojmë historikun e kësaj Biblioteke, ndeshim një mbijetesë të çuditshme profesionale e institucionale, prandaj kërkohen përcaktime konkrete rreth statusit të kësaj biblioteke.

Ndërkaq, Biblioteka Universitare nuk është pavarësuar asnjëherë si institucion i rëndësishëm arsimor e shkencor, duke mbetur në vijimësi e varur dhe e kufizuar në veprimtarinë e përgjithshme të saj.

Roli dhe rëndësia e definimit të çështjeve problemore të bibliotekave nuk mund të anashkalohet nga shoqëria dhe institucionet e Kosovës. Rrjeti i bibliotekave tona gjendet para sprovave të mëdha. Problemet e avancimit të veprimtarisë bibliotekare në Kosovë nuk maten vetëm me vëllimin dhe arritjen profesionale, por ato



janë të lidhura pashkëputshëm edhe me institucionet e tjera arsimore, ekonomike e financiare. Sfida të mëdha janë koordinimi dhe bashkëpunimi i duhur mes institucioneve tona, në mënyrë që të arrihet ndarja e Bibliotekës Universitare nga ajo Kombëtare, hapja e Degës së Bibliotekarisë në Universitetin e Prishtinës, buxhete të konsoliduara dhe të pasura për pasurimin e fondeve, automatizimin e bibliotekave, hapjen e sektorëve të rinj, pavarësimin e bibliotekave komunale, zgjerimin e hapësirave bibliotekare, zbatimin e standardeve bibliotekare, riorganizimin dhe kujdesin për bibliotekat publike e shkollore.

Njëra ndër sfidat më të ndjeshme është ajo e trajnimit dhe e shkollimit të punonjësve bibliotekarë jashtë dhe brenda vendit. Pra, përgatitja profesionale për përdorimin e programit të automatizuar për biblioteka, që nënkupton digjitalizimin e të dhënave bibliografike, ruajtjen dhe qarkullimin e tyre, krijimin e librit elektronik, digjitalizimin e materialeve audiovizuale (CD, DVD, fotografi, harta etj) etj. Ky komunikim, nëpërmjet rrjetit digjital të të dhënave bibli-

ografike - është shumë efikas dhe i shpejtë për kah sasia dhe cilësia. Tashmë Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka filluar fazën e zbatimit të kësaj teknologjie të avancuar me krijimin e katalogëve vijues dhe retrospektivë në programin e automatizuar ALEPH 500. Mbetet që tash bibliotekat publike të pajisen me këtë program të sofistikuar bibliotekar.

Në një vlerësim real të veprimtarisë bibliotekare, del se automatizimi i shërbimeve bibliotekare është sfidë e rëndësishme, në mesin e shumë të tjerave, që duhet t'i paraprijnë strukturimit modern të informacionit bibliotekar.

* * *

Një vëmendje të përqendruar kërkon njësimi paralel i standardeve ndërkombëtare të përshkrimit bibliografik (ISBD) (M) dhe (ISBD) (S), që ka filluar të zbatohet në vitet '80 në Kosovë. Ndërkaq, tash me zbatimin e programit të automatizuar ALEPH 500, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka filluar t'i zbatojë Rregullat Anglo-Amerikane të Katalogimit (AACR2), të cilat janë të integruara në Formatin MARC21. Dhe, meqë, në këtë program funksion

të veçantë kanë Emërtimet Lëndore, ka filluar edhe Klasifikimi Lëndor (në bazë të Listës së Emërtimeve Lëndore të Bibliotekës së Kongresit (Library of Congress Subject Headings – LCSH) dhe Listës së Sears-it (Sears List of Subject Headings), të shqipëruara dhe të përshtatura nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë), meqë deri tash është përdorur vetëm Klasifikimi Universal Decimal i Federatës Ndërkombëtare të Dokumentacionit - (FID). Pra, për katalogimin e materialeve në programet e automatizuara bibliotekare duhet të shtohet edhe një shërbim - Klasifikimi Lëndor – si klasifikim me fjalë, përveç atij Decimal – si klasifikim me numra.

Bibliotekat e Kosovës tashmë bashkëjetojnë me sfidat e së ardhmes, që mund të projektohen dhe të implementohen sipas prioriteteve - shkallëshkallë, duke filluar nga infrastruktura deri te ajo e krijimit të kuadrit të specializuar bibliotekar.

Nuk do të ishte ndjenjë e pëlqyeshme të dëgjohej a të thuhet se bibliotekat e tjera ndërkombëtare e klasifikojnë rishtazi materialin e këmbyer ose të dhuruar nga bibliotekat e Kosovës. Hulumtimi më i fundit tregon mangësi në këtë fushë të rëndësishme profesionale. Ja disa gabime të evidentuara në Klasifikimin Universal Decimal gjatë futjes së të dhënave bibliografike në Modulin e Katalogimit të programit të automatizuar ALEPH 500 në bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës: Matematika 2: për klasën e dytë të shkollës fillore (fletë pune), e autorit Kujtim Dedej, është klasifikuar si 372.851 (075.3), pra është gabuar plotësisht përcaktuesi i formës dhe në vend të përcaktuesit 2 - shkollat fillore, është futur përcaktuesi 3 - shkollat e mesme; Lahuta e Malcis e Gjergj Fishtës: studim monografik, e autorit Xhavit Aliçkaj, është klasifikuar 821.18.1. Këtu janë ngatërruar gjinitë letrare: *studimi monografik* është bërë *poezi*.

Kuadri bibliotekar

Mr. TAHIR FONIQI

Me shprehjen "kuadri bibliotekar" kuptojmë punëtorët profesionalë bibliotekarë, që kryejnë punë profesionale bibliotekare e që e kanë njërin prej thirrjeve: librar, librar i lartë, bibliotekar, bibliotekar i lartë dhe bibliotekar këshilltar. Thirrja "manipulant i bibliotekës" është hequr në ndërkohë, që nënkuptonte personin me shkollë fillore me apo pa provim profesional të bibliotekarisë. Thirrjet profesionale bibliotekare rregullohen me ligj dhe rregullore përkatëse. Duhet thënë se këto thirrje profesionale nuk arrihen lehtë. Që ta arrish titullin "bibliotekar këshilltar", lypset fakulteti, provimi profesional për bibliotekar, së paku dhjetë vjet përvojë pune në bibliotekë duke kryer punët më të ndërlikuara profesionale dhe punime të botuara nga fusha e bibliotekarisë.

NGRITJE CILËSORE KUADRORE

Shënimet e para, për kuadrin bibliotekar në Kosovë, i gjejmë më 1964. Këtë vit bibliotekat ekzistuese kanë pasur 57 punëtorë: 29 të përhershëm ose 50.8 për qind e 28 me honorar ose 49.1 për qind. Këtu ka dominuar kuadri me shkollë fillore 72.5 për qind dhe 27.5 me shkollë të mesme.

Rreth njëzet vjet më vonë, përkatësisht më 1986, në tre tipa të bibliotekave: Biblioteka Popullore dhe Univesitare e Kosovës, bibliotekat publike dhe bibliotekat universitare (të shkollave të larta e të fakulteteve) kanë punuar 400 punëtorë bibliotekarë, 343 më shumë se më 1964 ose 85.8 për qind. Përgatitja shkollore e këtij kuadri ka qenë: 1 magjistër ose 0.2 për qind, 57 me fakultet ose 14.2 për qind, 34 me shkollë të lartë ose 8.4 për qind, 254 me shkollë të mesme ose 63.5 për qind e 54 me shkollë fillore ose 13.5 për qind. Nga ky kuadër, 51 punëtorë e kanë pasur të krye provimin profesional të bibliotekarisë ose 12.7 për qind.

Në mbarim të vitit 2004, në bibliotekat publike në Kosovë, kanë

punuar 191 punëtorë profesionalë bibliotekarë, 24 më pak se më 1986 ose 12.6 për qind: 42 me fakultet ose 22 për qind, 29 me shkollë të lartë ose 15.1 për qind dhe 120 me shkollë të mesme ose 62.8 për qind. Më 2004, në këtë tip të bibliotekave, nuk ka punuar asnjë kuadër me gradë shkencore.

SECILI NË VENDIN E PUNËS SIPAS AFINITETIT

Në bibliotekat në Kosovë udhëhiqet edhe politikë "vangoshe" kuadrore profesionale bibliotekare. Kjo do të thotë nuk përfillet parimi i njohur bibliotekar "secili në vendin e punës sipas afinitetit". Është politikë e dështuar kuadrore, që kuadri i sapopranuar në bibliotekë, të vendoset menjëherë në vendin e caktuar të punës, pa shikuar se ai kuadër, ku dëshiron të punojë dhe për cilin vend të punës ka afinitet. Të gjitha ngeciat cilësore, rëniet e shkarjet në punët profesionale bibliotekare, në radhë të parë, janë rrjedhojë e përcmimit të këtij parimi. Përmirësimi i strukturës kuadrore bibliotekare, duhet të jetë në "dializë" të përhershme.

Gjatë mbulimit të vendeve të punëve bibliotekare, duhet mbështetur fort edhe në profilin shkollor. Kështu, në shërbimet e përpunimit të materialit bibliotekar, duhet angazhuar kuadër heterogjen dijesh 0|9, në shërbimet me lexues lypset angazhuar edhe sociologë e pedagogë, në shërbimin amë lypsen kuadro me prirje krijuese bibliotekare, në shërbimin e bibliografisë përparësia duhet të jetë për albanologët, meqë bibliografia është veprimtari intelektual kombëtare, ku duhet njohur mirë kulturën kombëtare, në koleksionet e veçanta duhet angazhuar njohës të kulturave dhe të gjuhëve të vjetra të qytetërimit etj.

PUNËTORI PROFESIONAL BIBLIOTEKAR DHE EKSPERTI BIBLIOTEKAR

Ekziston dallimi i dukshëm ndërmjet punëtorit profesional bibliotekar dhe ekspertit bibliotekar. Me këtë nuk

dua t'i zhgënjë punëtorët profesionalë bibliotekarë (bibliotekaria, në radhë të parë është veprimtari profesionale), por dua t'ua bëj me dije se shkencën e bibliotekarisë e përbën pjesa "shtesë" e kuadrit profesional bibliotekar, pra "shtresa" e ekspertëve, të cilët, pos njohjes solide të punëve profesionale bibliotekare, shquhen edhe me aftësi krijuese bibliotekare. Tekefundit, "Shkenca bibliotekare është disiplinë, e cila përfshin të gjitha aspektet e operacioneve bibliotekare" (Baçarov). Eksperti bibliotekar nuk formohet brenda natës, as brenda dy-tri vjetësh. Ai formohet për dhjetë, pesëmbëdhjetë e njëzet vjet, bile me përpjekje e punë vetëmohuese. Bibliotekaria është shkencë përplot sfida dhe e "ftohtë si mermeri". Të jesh profesionalist nuk do të thotë vetëm të njohësh dhe të zbatosh një grumbull të caktuar të aftësive, as të shkathtësive, por duhet të bazohemi në mënyrë të tërësishme sistematike e teorike. Në anën tjetër, të jesh ekspert bibliotekar, do të thotë t'i njohësh mirë të gjitha punët profesionale bibliotekare, që nga inventarizimi i materialit bibliotekar e deri te hartimi i të gjitha llojeve të bibliografive dhe, njëherësh, të dëshmosh aftësi krijuese bibliotekare. Është irritues glorifikimi i "rrethanave moderne bibliotekare": kompjuterizimi, Interneti, menaxhimi e format e tjera të ngjashme, pa ditur se, mbi të gjitha këto, qëndron përvoja dhe dituria paraprake bibliotekare. Këto janë themel i të gjitha proceseve bibliotekare.

PËRFUNDIM

Mbështetur në analiza të hollësishme, del se politika kuadrore, në bibliotekat tona, ka edhe defekte. E dihet organizimi dhe rregullimi profesional i materialit bibliotekar, si edhe të segmenteve të tjera bibliotekare, varet ekskluzivisht prej politikës së drejtë kuadrore brenda bibliotekave. Së këndejmi çështja e shqyrtimit kompleks të problematikës kuadrore dhe të shkollimit adekuat bibliotekar nuk mund të shtyhen më.

Dëmtimi i letrës

Letra është një shtresë e hollë e përbërë prej fibrash bimorë të thurura mirë njera me tjetrën. Celuloza, si përbërësi kryesor i letrës, është i ndjeshëm ndaj veprimeve të faktorëve fizikë, kimikë dhe mikrobiologjikë, të cilët shkaktojnë ndryshime të strukturave, që çojnë në dëmtimin e plotë të letrës, do të thotë asgjësim i dokumentit. Ruajtja e dokumenteve varet, gjithashtu, nga disa faktorë, si: kushtet e ambientit rrethues; cilësia e lëndëve të para prodhuese; përdorimi gjatë shfrytëzimit (nga përdoruesi).

Prej kohës së të qenit tekst i botuar, letra pëson një vjetrim natyral të pashmangshëm - ndryshojnë disa veti kimike e fizike të saj. Gjatë kësaj kohe, varësisht nga vendi dhe mënyra e ruajtjes, materiali bibliotekar iu nënshtrohet dëmtuesve, të cilët mund të jenë:

- dëmtues biologjikë: mikroorganizmat, kërpudhat, bakteret, insektet dhe breqësit etj.;
- dëmtues fizikë: ndriçimi i fortë, nxehtësia, pluhuri, etj.;
- dëmtues kimikë: acidet dhe gazrat e tjera atmosferike, kemikalet e ndryshme të përdorura gjatë përfutimit të letrës etj..

Cilësitë e letrës varen nga përbërja e celulozës (celuloza është përbërësi kryesor i letrës) prej së cilës është prodhuar, prandaj edhe jeta e dokumentit përcaktohet nga vetitë e fibrave të letrës. Sa më e madhe të jetë "n" (numri i atomeve të c - karbonit) i molekulës së celulozës, aq më e gjatë dhe më rezistente është fibra dhe po aq e fortë del letra e prodhuar prej saj. Në temperaturë të zakonshme, celuloza është e qëndrueshme, por me rritjen e temperaturës, ajo dekompozohet, duke dhënë celulozën e oksiduar (një komponim në trajtë pluhuri). Drita, gjithashtu, shkatëron molekulën e celulozës në prani të O₂. Celuloza është e ndjeshme ndaj acideve inorganike, të cilat e hidratojnë atë deri në glukozë. Të gjitha këto veti të celulozës kushtëzojnë ruajtjen e dokumentit (materialit bibliotekar) në kushte të caktuara. Sa më shumë celulozë të përmbajë letra, aq më e gjatë do të jetë makromolekula e celulozës e aq më rezistuese dhe jetëgjatë janë fibrat që e përbëjnë atë. Pra, në këtë kontekst, edhe koha e ruajtjes së kësaj letrë do të jetë më e gjatë.

Letra mund të dëmtohet edhe nga vjetërsia. Nga acidet: letra forcohet, bëhet e thyeshme (kërçet) gjatë shfletimit, kurse nga kërpudhat - zbutet, dobësohet dhe shfletohet pa u thyer.

Dëmtimi i materialit bibliotekar ndodh edhe nga faktorë natyrorë e aksidentalë, si: fatkeqësitë elementare, dëmtimi nga pëmbytja (vërshimet), tërmetet, zjarret etj..

DËMTIMET BIOLOGJIKE

Bakteret

Bakteret janë mikroorganizma elementarë, në shumicën e rasteve njëqelizore, me dimensione dhe forma të ndryshme. Ato karakterizohen nga vetia për t'u shumëzuar shumë shpejt, prandaj grumbullohen në formë cipash (shtresash kolonish, që dallohen me sy). Bakteret gjenden në ujë, në tokë dhe në ajër dhe mund të jetojnë në kushte të vështira jetësore, ndërsa për zhvillimin e tyre nevojitet lagështia. Bakteret e shkatërojnë përbërësin kryesor të letrës - celulozën, në kushte normale. Në kushte me lagështi më të madhe të ajrit, ato nuk paraqesin rrezik të menjehershëm, në rastin konkret për materialet nga të cilat përbëhen librat. Në rastet e lagjes së librave, substancat ngjitëse dhe pjesët prej lëkure të librave dëmtohen me shumë, për shkak se veprimtaria aktive e baktereve është në mjedis të lëngët. Produkte të metabolizmit të baktereve janë dyoksidi i karbonit, acidet organike, ketonet, aldehidet etj., komponime këto që e dëmtojnë letrën.

Kërpudhat

Dëmtimi e letrës (librit) që bëhen nga kërpudhat i përshkojnë njollat me ngjyrë të zezë të mbylltë, si dhe të gjelbër të mbylltë. Kërpudhat e zërthejnë celulozën dhe për këtë arsye mund të jetojnë dhe të zhvillohen në letër, meqë ushqehen me të. Disa kërpudha, për ushqim e përdorin ngjitësin, disa të tjera yndyrat, pluhurin, mbeturinat e ushqimit etj.

Disa autorë i përmendin deri në 300 lloje të kërpudhave që i dëmtojnë librat dhe dorëshkrimet. Identifikimi i dëmtimit nga kërpudhat bëhet lehtë, meqë letra zbutet dhe dobësohet, si dhe shfletohet pa u thyer.



Libri i dëmtuar nga kërpudhat

Insektet

Insektet janë organizma shumë qelizorë që jetojnë në të gjitha viset e botës, por më së shumti në viset e nxehta dhe me lagështi (viset me klimë të nxehtë) dhe secili lloj e ka vendin e tij të preferuar për jetë.

Insektet dëmtojnë letrën (librat) në shumë pjesë të saj, si: në pjesët sipërfaqësore, kopertina, në rastet e dëmtimeve të rënda - tërë materialin. Për ta mbrojtur materialin nga insektet, duhet njohur mirë jetën e tyre, si: ndërtimin trupor, zhvillimin, mënyrën e jetës, të ushqyerit.

Llojet që i sulmojnë librat, dorëshkrimet e dokumente të ndryshme në letër, jetojnë si larva - disa muaj deri në dy vjet, ndërsa si adultë (të rritura, të pjekura) vetëm 1-2 muaj.

Shumica e insekteve zhvillohen në vende të errëta, të lagështa dhe pak të ajrosura. Temperatura optimale për zhvillimin e insekteve është (25-30) OC. Shumica e tyre ushqehen me një numër të madh të materieve organike, si: celulozë, amidon (nisheste), albumina, sheqema etj.

Numri i insekteve që jetojnë në biblioteka dhe në arkiva është relativisht i madh. Insektet që jetojnë në biblioteka mund të jenë banorë të rastit (të përkohshme), por edhe banorë të përhershëm; insektet që ushqehen me dru dhe me mbeturina ushqimore, mund të gjenden rastësisht në biblioteka, sepse aty e gjejnë ushqimin e tyre të preferuar.

Krimbat e librave

Janë insekte që më së shumti i dëmtojnë librat dhe si dëmtues specialë, kur zhvillohen, me vështirësi eliminohen. Ushqimi i tyre i preferuar është nga materiet organike: lëkura, mielli, albuminat etj. Krimbat e librit, vezët e tyre i vendosin afër lidhjes së librit ose në vijat e librit. Pastaj larvat shkojnë kah brendia e librit ,duke hapur tunele dhe kthehen prapa kah sipërfaqja e jashtme, ashtu që insektet e mitura (adutë) kthehen në sipërfaqe.

DËMTIMET FIZIKE

Dëmtimet fizike shkaktohen nga pluhuri, ndriçimi, temperatura etj.

Pluhuri, gazrat dhe partikulat (grimca) e grumbulluara janë të dëmshme. Në rastin konkret do të ndalemi vetëm te dëmtimi nga pluhuri. Grimcat e ndotjes janë nga pluhuri, hiri, duhani, papastërtia dhe shumë spore; grimcat e ndotjes mund të vijnë nga shfrytëzimi i teksteve, nga muret e objektit, nga hyrja e dalja e personave etj. Pluhuri shërben si bazë për vendosjen e pluhurit tjetër mbi letër. Nëse ka lagështi, pluhuri shërben si bazë e mirë për zhvillimin e mikroorganizmave, të cilët në letër të pastër nuk do të zhvilloheshin.

Insektet më parë do ta sulmojnë letrën e papastër pastaj atë të pastër. Me rëndësi të posaçme është edhe ventilimi, ngaqë përmbajtja e ajrit të papastër (mosqarkullimi i ajrit) do të ndikojë në vjetrimin natyral të letrës. Të gjitha materialet, sidomos ato të rëndësishme së veçantë, është mirë të ruhen në kuti me koper-tina nga kartoni neutral, duke pasur kujdes që të mos shtrëngohen shumë, sepse mund të dëmtohen.

DËMTIMET KIMIKE

Dëmtimet kimike rrjedhin nga fenomenet me natyrë kimike, që zhvillohen në brendësi, duke e shkatërruar atë. Ndryshimet kimike mund të jenë të brendshme dhe të jashtme.

Ndryshimet kimike të brendshme - vijnë si rezultat i shpërbërjes së komponentëve përbërës të letrës, të cilët janë të lidhur me procesin e prodhimit teknologjik dhe përbërjes së saj. Letra si element me përbërje organike pas një ruajtje të gjatë pëson një sërë ndryshimesh fiziko-kimike. Ky ndryshim quhet vjetrim natyror i materialeve.

Letra dhe materialet e lidhjes (p. sh. lëkura, kartoni), duke u vjetërsuar, humbasin fortësinë mekanike, bëhen të brishtë, të thyeshëm, zverd-



Kuti prej kartoni me pH neutral

hen dhe me kohë mund të kthehen në pluhur. Procesi i vjetërimit të letrës është problem mjaft i rëndësishëm për të gjithë ruajtësit e dokumenteve. Meqenëse të gjitha materialet organike janë dëmtues, është vështirë dhe kërkohet mund për t'i ruajtur koleksionet bibliotekare. Procesi i "vjetërimit natyror", mund të bëhet më i shpejtuar ose më i ngadaltë, varësisht nga kushtet e ruajtjes. Vjetrimi i letrës ndodh edhe në kushte të mira të ruajtjes, por është shumë më i ngadaltshëm. Shkaku kryesor i shkatërrimit natyror të materialeve varet nga përgatitja e letrës sot; shpesh po shfrytëzohen prodhime jokuilative të letrës. (Sulfati i aluminit $[Al_2(SO_4)_3]$, i cili përdoret gjatë procesit teknologjik hidrolizohet në prani të ujit dhe me këtë rast formohet acidi sulfurik (H_2SO_4); ky komponim është komponim acidik që i jep letrës karakter acidik).

Një nga faktorët e tjerë që kushtëzon qëndrueshmërinë e letrës është aciditeti i saj. Gjurmët e klorit (Cl), të cilat mbeten në letër nga procesi i zbardhjes, ndihmojnë në forcimin e veprimit të degradimit të sulfatit të aluminit, i cili reagon me klorin dhe formon klorurin e aluminit ($AlCl_3$), i cili në prezencë të ujit (H_2O) dhe (Cl) e të nxehtësisë së ajrit, shndërrohet në acid klorhidrik (HCl), acid ky, i cili e dëmton letrën.

Ndryshimet kimike të jashtme - vijnë si rezultat i aciditetit të shkaktuar nga gazrat, pluhuri, tymi që ndodhen në atmosferë. Këto quhen dëmtime nga ndotja atmosferike. Papastërtitë që përmban ajri janë pjesë të forta pluhuri dhe gazra të ndryshme me karakter acidik. Ajri i pastër dhe i thatë përmban: N (78.00%), O (20.95%), Ar (1.27%), CO_2 (O, 33%), si dhe elemente të tjera në sasi të vogla. Oksigjeni është tregues i mirë i pastërtisë në ambientet bibliotekare.

Pluhurat në përgjithësi e dëmtojnë letrën dhe kjo ndodh zakonisht në regionet industriale ku ka shumë pluhur (nga furat industriale, nga automobilat, nga ngrohja në shtëpi), sepse lirohet dyoksidi i sulfurit (SO_2), i cili shpejt oksidohet e kalon në treoksidin e sulfurit (SO_3) e ky i fundit në bashkëveprim me ujin e formon acidin sulfurik (H_2SO_4), i cili e zbrërthen celulozën dhe letra bëhet e thyeshme.

Dëmtimi me acide

Gazrat e ndryshme me karakter acidik, janë: dyoksidi i karbonit (CO_2), dyoksidi i sulfurit (SO_2), ozoni (O_3), të cilat e dëmtojnë shumë letrën. Me rëndësi për qëndrueshmërinë e letrës është ACIDITETI i saj para së gjithash përmbajtja e acideve të lira. Letrat që përmbajnë më pak acide janë më të forta (më të qëndrueshme).

Aciditeti i lartë e dëmton letrën kimikisht dhe fizikisht. Aciditeti ka një efekt shumë të dëmshëm mbi letër. Shkalla e dëmtimit të dokumenteve e të librave është e ndryshme; pjesët e predispozuar për t'u dëmtuar marrin ngjyrë të verdhë kafe, në këtë kontekst qendra (mesi) e materialit mbetet e pandryshuar. Letra me aciditet të lartë përfshihet në pH (4-5), ka ngjyrë të verdhë në kafe dhe është e thyeshme. Në vlerën e pH (3) dëmtohet lëkura e kjo do të thotë se lëkura është më e ndryshme nga aciditeti, pra dëmtohet më lehtë. Vlera e pH=7 (pH neutrale) për letër, më së miri do të ishte në mjedis neutral, mirëpo kjo shpesh është e pamundur, sepse në aciditetin e saj ndikon edhe ngjyra, ngjitësi, e faktorë të tjerë.

Përgatitën: Shqipe Dreshaj - Asllani,
Blerta Slisani

BKUK dhe sistemi i automatizuar i sigurisë së librit

LAVDIJE RRAHMANI

Me implementimin në BKUK të RFID teknologjisë, hyn në funksion sistemi i automatizuar i sigurisë dhe qarkullimit të materialit bibliotekar, që do të thotë se BKUK-ja, sa i përket sigurisë së materialit bibliotekar dhe qarkullimit të tij, do t'u bashkëngjitet radhës së bibliotekave të modernizuara.

Meqë kohë më parë BKUK-ja ka filluar punën me sistemin e automatizuar të përpunimit të materialit bibliotekar, u krijuan kushtet për vënien në funksion të një sistemi të automatizuar të sigurisë së këtij materiali. Pra, me implementimin RFID Sistemit, BKUK-ja hyn në radhën e bibliotekave të modernizuara botërore. Vënia në funksion e një sistemi të tillë dhe e një teknologjie kaq të avancuar ka rëndësi të madhe jo vetëm për BKUK-në, por për gjithë sistemin bibliotekar në Kosovë.

RFID Sistemi Bibliotekar ka filluar të përdoret në biblioteka nga viti 1990, dhe që nga ky vit përdorimi i saj është zgjeruar shumë shpejt. Ndryshe nga teknologjitë që janë përdorur më herët në biblioteka, RFID Sistemi Bibliotekar i çon përpara zhvillimet teknologjike sa i përket sigurisë së materialit bibliotekar si brenda ashtu edhe jashtë bibliotekës. Ky sistem bibliotekar është një kombinim i radio-frekuencës, teknologjisë bazë dhe teknologjisë së mikroçipit (microchip). Me qindra biblioteka në gjithë botën sot përdorin teknologjinë e këtij sistemi. Ajo sjell komoditet, lehtësi dhe më shumë efektivitet në menaxhimin e koleksioneve dhe sigurinë e tyre.

PERDORIMI DHE RËNDËSIA E RFID TEKNOLOGJISË NË BIBLIOTEKË

RFID (Radio Frequency IDentification) është sistem që e bën të mundur përcjelljen e materialeve bibliotekare kudo në bibliotekë, përfshirë këtu edhe procesin e huazimit dhe kthimit të materialit.

Aktivitetet bibliotekare që mund të përfitojnë nga RFID teknologjia janë:

- Qarkullimi: verifikimi i daljes së librave ose i materialeve të tjera, si dhe kthimi i tyre;
- Mbikëqyrja e inventarit: sigurimi se secila njësi është në vendin e vet (vendndodhja e kopjeve përputhet me shënimet e inventarit);
- Përpunimi i librit: shtimi i kopjeve në koleksionet e bibliotekës

Përdorimi i RFID sistemit ul në masë të madhe kohën që nevojitet për kryerjen e operacioneve (punëve) në qarkullim. Koha më e madhe e kursyer i atribuohet faktit që informatat nga RFID tiketat mund të lexohen shumë më shpejt sesa nga barkodet e mëparshme, por, gjithashtu mund të lexohen në të njëjtën kohë kopjet e ndryshme në raft. Përdoruesi ka mundësi që të bëjë porosi për njësi të ndryshme në të njëjtën kohë.

Një përparësi e rëndësishme e RFID teknologjisë është aftësia e saj për të skanuar librat në rafte pa i përdoruar ose pa i lëvizur nga vendi. Hand-held inventory rider (lexuesi i inventarit) mund të lëvizet shpejt përreth raftit të librave për të lexuar të gjitha informatat identifikuese të veçanta.

Përdorimi i RFID teknologjisë në bibliotekë lehtëson dhe shpejton në masë të madhe punën e bibliotekarëve dhe shërbimin e përdoruesve:

- kursen kohën e verifikimit të daljes së materialit dhe të kthimit të tij;
- minimizon shansin për humbjen e materialit;
- bën të mundur zëvendësimin e menjëhershëm të materialit të humbur;
- shkurton kohën për kthimin e materialit bibliotekar;
- thjeshtëson procesin e huazimit të materialit dhe kthimit të tij;
- ofron më shumë qasje për përdoruesit.

KOMPONENTËT E RFID SISTEMIT DHE EFEKTI I TYRE NË BIBLIOTEKË

RFID sistemi ka tri komponentë:

- RFID labels (tiketat) - në të cilat janë të programuara në mënyrë elektronike një sasi e vogël informatash;



- Pajisjet për leximin e informatës – lexuesit (readers) ose zbuluesit (sensors) e RFID tiketave, të cilët janë të lidhur me sistemin informativ të bibliotekës;
- Antenat, të cilat janë të lidhura me pajisjet lexues, dhe emetojnë të dhëna nga dhe deri te RFID tiketat.

Kombinimi i pajisjes lexues dhe antenës përbën një RFID station. Komunikimi mes RFID tiketës dhe RFID station bëhet në distancë, pra leximi i të dhënave nga RFID tiketa bëhet nga një distancë e caktuar.

RFID LABELS (TIKETAT)

Bërthama e RFID Sistemit Bibliotekar është RFID tiketa. Secila tiketë përmban një antenë dhe një mikroçip me një kapacitet prej disa bitë dhe nuk është më e madhe se një kartelë kredie. Këto tiketa mund të tregojnë më



shumë informacione për një njësi sesa një barkod i thjeshtë i përdorur më herët në sistemet bibliotekare. Vendosen në libër, CD, DVD dhe në materiale të tjera. Këto tiketa përmbajnë informacione, si: numrin e barkodit, autorin, titullin, kodin e bibliotekës, informacionin për vendndodhjen e njësisë, statutin e njësisë (a mund të huazohet jashtë bibliotekës) etj.

Etiketimi i materialeve bibliotekare kërkon një trajnim prej 15 deri në 20 minuta. Derisa për materialet e tjera, si:

CD, DVD dhe videokaseta, nuk ka shumë zgjidhje për vendosjen e tiketave, për librin ka më shumë opsione. Është e rëndësishme që të zgjidhet vendi i qëndrueshëm për etiketimin e librave.

Vendosja e tiketës në brendi të librit është më e preferuar për shkak të ruajtjes nga dëmtimet e ndryshme gjatë procesit të qarkullimit të materialit bibliotekar.

Brendësia e kopertinës së fundit është vendi i rekomanduar, sepse etiketimi do të bëhet më shpejt dhe më lehtë se në çdo lokacion tjetër. Kjo do të mënjanojë përzierjen (ndërhyrjen) e metalit të rafteve derisa bëjmë leximin e njësisë (inventarizimin). Për sigurinë sa më të madhe të materialit bibliotekar, në Bibliochip tag (tiketë) kodohet vetëm një numër identifikues, prandaj kjo bën të pamundur marrjen e informatave të tjera për njësinë e caktuar, si dhe për njësitë e radhitura në raft, mirëpo kjo nuk do të thotë se ato nuk mund të përmbajnë informata të tjera shtesë.

PAJISJET LEXUES - READERS

Sisteme të ndryshme përdorin disa lloje të ndryshme të këtyre pajisjeve; gjithashtu përdoren si zbulues kur instalohen në daljet e bibliotekës. Këto janë pajisje të dizajnuara për t'i detektuar dhe për t'i lexuar tiketat, në mënyrë që të

merren informatat që janë të regjistruara në të. Fuqia e antenës së pajisjes për lexim prodhon një fushë RF (fushë me radio-frekuenca). Kur tiketa kalon nëpër këtë fushë, informatat e regjistruara në Çipin e tiketës dekodohen nga kjo pajisje dhe dërgohen në server, i cili, si përgjigje, komunikon me sistemin e automatizuar të bibliotekës në të cilin është i integruar RFID Sistemi.

Pajisjet-lexues përdoren në qarkullim për huazimin dhe kthimin e materialit bibliotekar; vetë huazimin nga ana e përdoruesit,

si dhe në funksionin e zbuluesit nëpërmjet detektimit dhe leximit të informacionit që bartin RFID tiketat, me qëllim që të determinohet koha e huazimit dhe e kthimit të materialit. Gjithashtu, ka mundësi që kjo pajisje të instalohet edhe në bartësin e librave - për kthimin e materialeve dhe identifikimin e tyre në mënyrë automatike, derisa ata kalojnë nëpër të. Pra, kjo pajisje është mjaft e përshtatshme të përdoret si pajisje për të lexuar informatat nga grupe njësisë në rafte me qëllim që të lokalizojë gabimet në radhitjen e njësisë.

Pajisjet lexues në sistemin bibliotekar RFID kanë përdorim mjaft të gjerë. Ato mund të përdoren për disa funksione:

- Conversation stacion - përdoret për futjen e të dhënave në RFID tag;
- Staff workstation at circulation - përdoret për të kontrolluar daljen dhe hyrjen e materialit bibliotekar;
- Patron seli check-out stacion - përdoret për ta kontrolluar daljen e materialit pa mbikëqyrjen e anëtarëve të stafit;
- Exit sensors - bën verifikimin se të gjitha materialet që kanë dalë nga biblioteka janë evidentuar;
- Patron seli check-in stacion - përdoret për të kontrolluar kthimin e materialit pa mbikëqyrjen e anëtarëve të stafit;
- Book drop reader - përdoret për kontrollimin e materialit derisa përdoruesi e kthen atë në book-drop (bartësi i materialit);
- Portable reader - bën verifikimin e njësisë të kthyer dhe vendosjen e tyre në mënyrë korrekte në raft.

RFID Sistemi në mënyrë të veçantë u adresohet nevojave të menaxhimit të qarkullimit të materialit bibliotekar dhe zbulimit të keqpërdorimeve të tyre. Ky sistem mundëson shkurtimin e kohës së procesimit të materialeve në masë shumë të madhe, si dhe eliminon kohën e shpenzuar për verifikimin e njësisë në raft derisa shikojmë për njësi të humbura ose për gabime në radhitje.

Vizitë e rëndësishme për të orientuar ndryshimet e ardhshme në BKUK

Me organizimin e Zyrës së ShBA-ve në Prishtinë, Departamenti i këtij Shteti, përkatësisht Zyra për Edukim dhe Çështje Kulturore në bashkëpunim me Delphi International Program of World Learning, mbështetën projektin e quajtur Administrimi i bibliotekave në ShBA, në të cilin drejtori i BKUK, Dr. Sali Bashota, mori pjesë dhe pati takime të rëndësishme me personalite të njohura të fushës së bibliotekarisë dhe të kulturës.



Drejtori i BKUK-së - Dr. Sali Bashota, gjatë vizitës në Amerikë, u njoftua me sistemin e bibliotekave publike në ShBA dhe pati diskutime të frytshme me ekspertë profesionistë në bibliotekat publike dhe akademike; se si politikat dhe fondet e bibliotekave janë të zhvilluara dhe të përkrahura nga qeveritë lokale, shtetërore, federale; përdorimi i teknologjisë informative në bibliotekat publike, në rritjen dhe shpërndarjen e informacioneve përmes katalogut on-line dhe bazës së të dhënave. Vizita e parë e Dr. Bashotës ishte ajo në Uashington - në Bibliotekën BENDER, ku u takua me Patricia Wand, nga Biblioteka Universitare, e cila dha një përshkrim për sistemin e bibliotekave universitare amerikane, duke shpjeguar proceset e themelimit të bibliotekave private universitare.

Drejtori u BKUK-së u prit edhe nga zyrtarë të lartë të Qendrës Delphi International Program of World Learning, me Kim Havenner dhe Christina Thomas; nga drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Bibliotekave Amerikane (ALA) - Emily Sheketoff, ku u diskutua për sistemin bibliotekar në ShBA, për historinë e bibliotekave edhe për kontributin e tyre në shoqërinë civile.

Vizita me interes ishin edhe ajo në Bibliotekën MELVIN GELMAN, në Universitetin George Washington. U vizitua edhe Këshilli Kombëtar i Bibliotekave dhe Shkencave Informative, i udhëhequr nga dr. Trudi Hahn, drejtor Ekzekutiv, në të cilin u njoftua për programet funksionale për qasje në shkencat informative dhe për qasje në biblioteka.

Me rëndësi të veçantë qe vizita në Bibliotekën e Kongresit, më e madhja në botë, ku drejtori i BKUK-së u takua me përfaqësuesit e kësaj biblioteke, me ndihmëdrejtorin e saj Robert Dizard, pastaj me dr. Don Panzerën, drejtor i Pasurimit të Divizionit Evropo- Latino-Amerikane, si dhe Grant Harris, specialist në këtë bib-

liotekë, i cili kohë më parë pati vizituar BKUK-në. Në këtë takim u diskutua për bashkëpunim të mëtutjeshëm të Bibliotekës së Kongresit dhe BKUK-së. Institucione të tjera me rëndësi, të cilat u vizituan, ishte edhe Këshilli i Bibliotekës për Burime Informative - CLIR; vizita në Institutin e Muzeut dhe Shërbimeve Bibliotekare, me përfaqësues dhe udhëheqës të lartë të këtij instituti; vizita në Bibliotekën Memoriale Martin Luter King Jr. në Uashington.

Drejtori i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare, vizitoi edhe biblioteka të tjera qëndrore e speciale, në vende e rajone të ndryshme, si në: San Diego, Kalifornia, si dhe në Bibliotekat e Qarkut të Solana Beach, Cardiff dhe takoi profesor e specialist të fushës së bibliotekarisë; Denver, Kolorado.

Në Denver, Dr. Sali Bashota u prit nga përfaqësues të Bibliotekave, intelektualë e specialistë të shkencave të ndryshme, shkrimtarë e udhëheqës të asosacioneve të ndryshme për hulumtime kulturore e shkencore;

Në Columbus, Ohio, Nju Jork, vende në të cilat u informua për programet e reja amerikane për biblioteka, zhvillimin e hulumtimeve shumëgjuhësore, decentralizimin e pasurimit dhe vendimmarrjen për pasurim. Në Bibliotekën Publike të Nju Jorkut, u diskutua kryesisht për burimet elektronike, përfshirë bisedat për digjitalizimin e njëjësive bibliotekare, koleksionet digjitale, bashkëpunimin ndërmjet bibliotekave etj.

Drejtori i BKUK, Dr. Sali Bashota u shpërblye me Mirënjohje nga Delphi International Program of World Learning, e cila iu dedikua zhvillimit të suksesshëm dhe ndryshimeve në BKUK.

Përgatiti: Sh. RAMA

BKUK-ja HAP BIBLIOTEKËN E ARTIT BASHKËKOHOR

(23 shtator 2005)

Biblioteka e Artit Bashkëkohor, e cila u hap në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, është njëri ndër projektet e rëndësishme që sjell burime të reja nga fusha të ndryshme të arteve dhe ka për qëllim kryesor të ofrojë modelin e një biblioteke moderne me botime të një spektri të gjerë.

Ideja për themelimin e kësaj Biblioteke ishte nga Fondacioni Kulturor Federal i Gjermanisë, në vitin 2004, në mënyrë që të inicohet shkëmbimi dhe komunikimi i vlerave mes Gjermanisë dhe shteteve të tjera të Evropës Lindore.

Nga Marrëveshja e Mirëkuptimit e nënshkruar ndërmjet Shannon Bool dhe Adrian Williams, përfaqësues të fondacionit, dhe drejtorit të BKUK-së - Dr. Sali Bashota, ndër të tjera, thuhet: "Academy Remix" (një prej nënprojekteve të projektit "Lidhjet") është përgjegjës për një numër aktivitete të përbrenda Kosovës, të cilat sigurojnë një avancim kul-



turor. Nën ombrellën e të dy lidhjeve Academy Remix-it, artistët e rinj nga Staedelschule në Frankfurt a.M, Gjermani dhe studentët që janë të përfshirë në Organizatën Exit Art në Prishtinë, Kosovë, u është mundësuar të realizojnë projekte individuale, të cilat kanë të bëjnë me zhvillimet kulturore".

Koleksioni i Bibliotekës së Artit Bashkëkohor zhvillohet dhe pasurohet njëkohësisht në Frankfurt dhe në Prishtinë dhe është i përbërë nga libra filozofikë, teorikë, letërsi, katalogë të ekspozitave, monografi të artistëve, CD, DVD etj.

Në ceremoninë solemne të themelimit të Bibliotekës së Artit Bashkëkohor morën pjesë personalitete të shumta të kulturës, të artit e të shkencës, ndërsa folën udhëheqësit e projektit - Adrian Williams dhe Shannon Bool nga Gjermania dhe drejtori i BKUK-së - Dr. Sali Bashota.

U PROMOVUAN VEPRA NË GJUHËN ANGLEZE NGA FUSHA E HISTORISË, LETËRSISË, ANTROPOLOGJISË DHE DIPLOMACISË SHQIPTARE

(23 shtator 2005)

Shtëpia Botuese Qendra për Studime Shqiptare dhe I.B.TAURIS në Londër në fillim të vitit 2005 botoi pesë tituj në gjuhën angleze nga fusha e historisë, letërsisë, antropologjisë dhe diplomacisë shqiptare: Gjashtë muaj mbretëri - Duncan Heaton - Armstrong, Shqipëria dhe mbreti Zog (vëllimi I, 1908 - 1939) - Owen Pearson, Historia e letërsisë shqipe - Robert Elsie, Shqipëria sot - Clarissa de Waal dhe Lahuta e Malcis e Gjergj



Fishtës, përkthyer nga Robert Elsie dhe Janice Mathie - Heck.

Me rastin e këtij promovimi, me kumtesa dhe fjalime u paraqitën: Drita Statovci, Avni Spahiu, Enver Hoxhaj, Shkëlzen Maliqi, Bejtullah Destani dhe Sali Bashota.

Organizator i promovimit të këtyre veprave ishte BKUK.


DONACION NGA RUMANIA PËR BKUK - ME VLERË TË RRALLË KULTURORE



Përkthyesi, poeti, publicisti shqiptar nga Rumania - Baki Ymeri, për BKUK-në ka sjellë donacionin e dytë të materialeve e dokumenteve me vlerë të veçantë kulturore e historike për shqiptarët, si: libra, dorëshkrime, revista, letra, fotografi, botime nga fusha e folklorit etj.

Ndër materialet me vlerë janë edhe: Albanica e Anton Balotës (Bukuresht, 1936), fq. 438, si dhe fotografi të ndryshme; Dardha, album turistik i realizuar nga Mitrush Kuteli, vepër e bukur, e rrallë dhe e vjetër (pa vit botimi); Albania e Dem Abeleanu-t, Çernauc (Ukrainë), 1928; Pranë kllanikut, e Aleko Vançit, Bukuresht, 1940, vepër e rrallë, me disa fotografi; Abetar i Vogël Shqyp, prej Lek Grudës, Bukuresht, 1906;

Nikolla Nacio, Demascarea unei Bande de Tradatori (Demaskimi i një bande tradhtarësh), Bucuresti, 1907; Intrigile straine in contra neamului albanez (Intrigat e huaja kundër kombit shqiptar), Bucuresti, 1907; J. Vreto, Numeratoreja, Bukuresht, 1886; M. Çami, Erveheja, Bukuresht, 1888; Shkronjëto e Gjuhësë Shqip, prej S.H.F., shtypur prej Shoqërisë Drita, Bukuresht, 1886, fq. 128 +10 etj..



BKUK NË KONFERENCËN E IFLA-S

(13 gusht 2005)

Drejtori i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, Dr. Sali Bashota, si dhe kryetari i Shoqatës së Bibliotekarëve të Kosovës Besim Kokollari, me ftesë zyrtare nga IFLA (Federata Ndërkombëtare e Asociacioneve Bibliotekare), morën pjesë në Kongresin e 71-it të kësaj Federate, i cili u mbajt në Oslo të Norvegjisë.

Në kryeqytetin e Norvegjisë u mbajt Konferenca e bibliotekave botërore, e cila kishte për qëllim promovimin e mirëkuptimit ndërkombëtar, të bashkëpunimit; diskutimin e çështjeve të ndryshme, hulumtimit dhe zhvillimit në të gjitha veprimtaritë bibliotekare dhe të shkencave informative në nivelin ndërkombëtar.

IFLA ka mëse 1500 anëtarë nga 140 vende të botës, në mesin e të cilave është e anëtarësuar edhe BKUK.

Gjatë kësaj konference, përfaqësuesit e BKUK-së patën takime zyrtare të nivelit të lartë me përfaqësues të ndryshëm të bibliotekave botërore nga Evropa dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Takime të veçanta delegacioni nga Kosova ka pasur me Nancy Davenport, presidente e Këshillit të Bibliotekës për Burime Informative (CLIR) nga SHBA, Frode Bakken, Kryetar i Shoqatës së Bibliotekarëve të Norvegjisë, Marsel Nauer, drejtues i Kompanisë Bibliotheca RFID, J. E. Roed, Drejtor i Bibliotekës Universitare të Norvegjisë etj.



BIBLIOTEKARË NGA KOSOVA DO TË AFTËSOHEN NË SHBA



(Prishtinë, 19 gusht 2005)

Zyra e SHBA-ve në Prishtinë me kënaqësi njofton se 9 bibliotekarë nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës janë zgjedhur për të marrë pjesë në trajnim në një SHBA, që do të mbahet në Simmons College në Amherst, shteti Massachusetts. Përzgjedhja është bërë bashkërisht nga Zyra e SHBA-ve në Prishtinë, Instituti për Trajnim dhe Zhvillim (ITD) dhe Fakulteti i Bibliotekarisë dhe Shkencave të Informacionit (GSLIS) në Massachusetts, SHBA, si dhe Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë e Kosovës. (MASHT).

Ky trajnim është një pjesë e përpjekjeve të Qeverisë së SHBA-ve për të ndihmuar zhvillimin dhe modernizimin e Bibliotekave të Kosovës. Kurset pasdiplomike do të përfshijnë instruksionet e specializuara për zhvillimin dhe menaxhimin e koleksioneve, shërbimet e informacioneve nëpërmjet internetit (online), referencat virtuale, si dhe përfitimet dhe sfidat e informacioneve digjitale dhe teknikat e tanishme menaxhuese në bibliotekat universitare në Amerikë. Ky projekt ka dy pjesë kryesore: pjesa e parë është trajnimi në SHBA që do të mbahet prej 21 gushtit deri më 17 dhjetor të vitit 2005; pjesa e dytë është faza pas trajnimit, që përbëhet nga aktivitetet në Kosovë gjatë vitit 2006.

Pjesëmarrësit në këtë trajnim janë: Shukrije Rama, Besim Kokollari, Bedrije Mekolli, Bukurije Haliti, Ramush Zeka, Elhame Buzuku, Ardian Haxhaj, Barlet Berisha dhe Urim Sallauka. Më herët, gjatë kësaj jave, ata u takuan me shefin e misionit të Zyrës së SHBA-ve në Prishtinë Philip Goldberg, i cili i uroi ata që janë përzgjedhur për këtë trajnim.

Zëvendëshefi i sektorit për marrëdhënie publike në Zyrën e SHBA-ve në Prishtinë, Wendy Kolls shtoi se "këta 9 bibliotekarë do të jenë të parët në Kosovë që janë trajnuar në mënyrë profesionale dhe moderne për shkencën e bibliotekarisë, dhe ata do të luajnë një rol të rëndësishëm në përcjelljen e dijenisë së tyre te kolegët dhe për t'i ofruar informata opinionit kosovar".

Dr. Sali Bashota, drejtori i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës do t'i bashkohet këtij grupi gjatë javës së fundit të këtij trajnimi e që është në kuadër të programit të përgjithshëm të Zyrës së SHBA-ve për bibliotekë.

(Informacion i dhënë nga Zyra e SHBA-ve në Prishtinë)



TRAJNIME NGA FUSHA E KLASIFIKIMIT LËNDOR

Me ftesë të BKUK-së drejtuar Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, prej 7-9 shtator 2005, u organizua një trajnim nga znj. Behije Luga, udhëheqëse e Departamentit të Informatikës dhe Teknologjive të Reja në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë. Ky trajnim ishte i domosdoshëm për shkak të nevojave për njohjen e klasifikimit lëndor, pas fillimit të punës në programin e automatizuar bibliotekar Aleph500/ ExLibris në BKUK. Në këtë trajnim nga fusha e klasifikimit lëndor, morën pjesë punëtorë nga BKUK-ja dhe nga bibliotekat ndërkomunale të Kosovës.

Më pas, trajnimet kanë vijuar nga po kjo fushë në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, ku nga BKUK-ja ishin një grup prej 5 punëtorëve. Trajnimi u organizua prej 25-30 shtator 2005.

Këto dy trajnime bënë të mundur që puna e filluar në katalogun elektronik Aleph500/ ExLibris, të plotësohet dhe të profesionalizohet edhe me klasifikimin lëndor.

SHKRIMTARI JEVREM BRKOVIQ VIZITOI BKUK-NË

(1 nëntor 2005)

Shkrimtari i mirënjohur malazias Jevrem Brković, i cili është laureat i sivjemë i Manifestimit poetik Ndërkombëtar "Kepi i Shpresë së Mirë - Fahredin Gunga", në kuadër të vizitës së tij që i bëri institucioneve qeveritare dhe kulturore, ndër të tjera, e vizitoi edhe Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Jevrem Brković, gjatë kësaj vizite, i dhuroi kompletin e veprave të veta Bibliotekës



Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, të përbërë nga 31 tituj - llojesh dhe zhanresh të ndryshme: prozë, poezi, dramë, ese, publicistikë, polemikë etj..

Gjatë takimit me Dr. Sali Bashota, drejtor i BKUK-së, u bisedua edhe për nevojat e bashkëpunimit kulturor mes institucioneve të Kosovës dhe të Malit të Zi.

Përgatiti: Fatmire RAMADANI

KOSOVA DHE TROJET SHQIPTARE NË ISH JUGOSLLAVI (Bibliografi e anotuar) I: nga lashtësia deri në vitin 1912, Tiranë 2005



Një nga bibliografitë e rralla (ndoshta e vetmja) që trajton të kaluarën e largët të Kosovës në aspektin bibliografik, është vëllimi bibliografik *"Kosova dhe trojet shqiptare në ish Jugosllavi (Bibliografi e anotuar) I: nga lashtësia deri në vitin 1912"*, Tiranë 2005, e autores znj. Afërdita Sharxhi, aktualisht bibliografe në Departamentin e Albano-Balkanologjisë në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë dhe autore e bashkautore e disa bibliografive, ndër to edhe edhe *"Albanica I (shek. XIV - XVIII), Tiranë 1998"*.

Bibliografia në fjalë përmban të dhëna me interes për gjendjen politike, ekonomike e shoqërore të këtyre trevave shqiptare që nga Dardania dhe dardanët, pastaj për sundimin osman, për kryengritjet antiosmane, për marrëdhëniet tregtare mes qyteteve shqiptare dhe Republikës së Venedikut, për Traktatin e Shën Stefanit dhe atë të Berlinit, për rolin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e deri në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 1912.

Në këtë vëllim bibliografik, që përmban 406 njësi bibliografike, janë përfshirë vepra të ndryshme, udhëpërshkrime, vjetarë të Perandorisë Osmane për Vilajetin e Kosovës e të Manastirit, artikuj të periodikut, dokumente, akte ndërkombëtare e memorandume me interes për problemin e Kosovës e të trojeve shqiptare në Mal të Zi. Në fund të vëllimit bibliografik, një vend të veçantë zënë hartat, të cilat u takojnë hartografëve më në zë të shek. XVI - XIX, si: Mercator, Gastaldo, Cantelli, Coronelli etj., në hartat e të cilëve janë paraqitur trojet shqiptare, përfshirë edhe territorin e Kosovës nën emërtimet Albania (Albanie), Haute Albanie, Epiro (Epire), Albania pars Illyridis etj.

Në bibliografi, veprat dhe artikujt janë renditur alfabetikisht sipas autorit ose titullit të veprës, kurse hartat përshkruhen me renditje alfabetike më vete, por me numër rendor në vazhdim. Një rëndësi të jashtëzakonshme kanë shënimet në gjuhën shqipe për çdo njësi bibliografike, të cilat kanë të bëjnë me përmbajtjen e veprës dhe të dhënat e veçoritë e botimit. Natyrisht se një punë kaq e vështirë është arritur në sajë të një përvoje të gjatë të autores në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë dhe në sajë të njohjes së disa gjuhëve të huaja, e sidomos latinishtes, si një gjuhë e vdekur, por shumë e nevojshme për studiues.

Në fund bibliografia ka treguesin e personave për të cilët flitet në vepra, treguesin gjeografik dhe atë lëndor, të cilët e lehtësojnë punën kërkimore të studiuesve.

Vëllimi bibliografik "Kosova dhe trojet shqiptare në ish Jugosllavi" pasqyron më së miri punën këmbëngulëse të znj. Afërdita Sharxhi, për të depërtuar hollësisht në përmbajtjen e fondeve dhe për t'i përpunuar ato në mënyrë profesionale. Dhe, së fundi, botimi i kësaj bibliografie, si vëllim i parë (I), na inkurajon së autorja do të vazhdojë punën e saj edhe me ndonjë vëllim të dytë.

BEKTASHIZMI NË SHQIPËRI (Bibliografi), albPAPER, Tiranë 2004

Një nga variantet e ashtuquajtura liberale të fesë islame të shqiptarët - *bektashizmi*, (i njohur si një lloj protestantizmi i besimit islam), që prej shekujsh ka tërhequr vëmendjen e udhëtarëve dhe studiuesve të huaj, të cilët kanë shkruar mijëra faqe mbi këtë temë, me interes edhe për botën shkencore.



Në sajë të këtij interesimi, autorët Maksim Gjinaj, Petrit Bezhani dhe Nuri Çami, iu përveshën punës dhe pas tri vjetësh pune hulumtuese, hartuan një bibliografi voluminoze me titull: *"Bektashizmi në Shqipëri"*, e cila u nxit dhe u ndihmua nga Kryegjyshi Botëror Bektashian - Haxhi Dede Reshat Bardhi.

Për hartimin e një bibliografie të tillë, autorët, shfrytëzuan botimet albano-balkanologjike të autorëve shqiptarë e të huaj, si dhe shkrimet e botuara në periodikun shqiptar e atë të huaj, që trajtojnë problemet e bektashizmit të shqiptarët.

Sipas autorëve, literatura e shkruar për besimin bektashian në gjuhën shqipe zë fill që në shekullin e XVIII, kur u shkruan vargjet e para për lindjen e profetit Muhamed a.s. e vijuan edhe në shekujt pasardhës, por botimet e mirëfillta artistike e shkencore, që trajtojnë filozofinë dhe çështje të tjera të këtij besimi, në përgjithësi - të atij shqiptar, në veçanti, u bënë kryesisht në gjysmën e dytë të shek. XIX e në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XX.

Një vend të veçantë në këtë bibliografi zënë veprat e udhëpërshkruesve dhe studiuesve të mirënjohur, si: E. Çelebiu, U. M. Lik, J. G. Hahn, J. Hobhouse, I. Manzouri, F. Babinger, P. Barlt, F. Hasluck, R. Elsie etj., të cilët jo vetëm që i shkelën vetë trevat shqiptare, por në veprat e tyre pasqyruan objekte e personalitete të besimit bektashian, të bëma e veprime të tyre, të ndryshme, probleme e marrëdhënie me përfaqësuesit e besimeve të tjera në Shqipëri.

Bibliografia në fjalë përmban 2 379 njësi bibliografike, të përcjella me shënime plotësuese. Renditja e njësisve është bërë në mënyrë kronologjike dhe brenda të njëjtit vit është bërë renditja alfabetike sipas autorëve. Për ta lehtësuar punën e përdoruesve, bibliografia është e pajisur me treguesin e autorëve, ku përfshihen edhe redaktorët, shqipëruarit, përgatitësit, komentuesit etj. Të një rëndësie të veçantë janë treguesi i personave për të cilët është shkruar, si dhe treguesi gjeografik dhe ai i objekteve fetare të këtij besimi. Së fundi, këtij qëllimi i ka shërbyer edhe treguesi tematik e lëndor, me të cilën është pajisur kjo bibliografi.

GJ. BERISHA